



**LEGJISLACIONI SHQIPTAR  
MBI  
STATUSIN E JETIMIT.  
ANALIZË E NEVOJAVE PËR NDRYSHIME.**

---

**SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri**

**Shtator 2012**



## Tabela e përmbajtjes

---

Falenderime .....	3
Shkurtime.....	4
I. Hyrje .....	5
II. Pjesa e parë - Ligji për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. ....	7
III. Pjesa e dytë - Shërbimi publik dhe jopublik. Situata e fëmijëve të institucionalizuar..	10
Institucionet e përkujdeset shoqëror publik dhe jopublik.....	10
<i>Shërbimi publik</i> .....	10
<i>Shërbimi jopublik</i> .....	13
Reforma.....	13
IV. Pjesa e tretë - Ligji për statusin e jetimit. Problematikat. ....	19
V. Pjesa e katërt - Detyrimet e organeve qendrore dhe mangësitë. ....	25
<i>Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta</i> .....	25
<i>Detyrimet e Ministrive të tjera</i> .....	26
VI. Pjesa e pestë - Sistemi legjislativ për fëmijët jetimë .....	28
<i>Kushtetuta</i> .....	28
<i>Konventat Ndërkombëtare të ratifikuara</i> .....	28
<i>Sistemi Legjislativ - LIGJET</i> .....	29
VII. Pjesa e gjashtë - Studim për largimin nga kujdesi publik aktual.....	34
VII. Pjesa e gjashtë - Sugjerime / rekomandime .....	44
Masat institucionale për mbrojtjen e fëmijëve jetimë dhe pa kujdes prindëror .....	44
Sugjerime / rekomandime .....	45
Literatura.....	46



## Falenderime

---

Ky studim u realizua nga SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri, mbështetur nga ekspertja e jashtme: Eralda Methasani, Qendra “Fëmijët SOT”.

Për realizimin e këtij studimi u zhvilluan disa takime me: Znj. Albana Shtylla, Drejtore e Drejtorisë Juridike, Znj. Denada Seferi, Drejtore e Politikave të Shërbimeve Sociale, Z. Mihal Naço, Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror, Znj. Arkida Hysenaj, Drejtore e Inspektimit të Standardeve në SHSSH, Z. Gazmend Zita shef sektori në Drejtorinë e Inspektimit të Standardeve për fëmijë në SHSSH, Znj. Ilda Poda, Specialiste në Drejtorinë e Politikave të Shërbimeve Sociale, Z. Kadri Aliaj - President i Shoqatës Kombëtare për Jetimët, të cilët i falënderojmë për kontributin e tyre.



## Shkurtime

---

MPÇSShB	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
ShSSH	Shërbimi Social Shtetëror
SHKP	Shërbimi Kombëtar i Punësimit
OJF	Organizata jofitimprurëse
NJDF	Njësitë për të Drejtat e Fëmijëve
NJMF	Njësitë për mbrojtjen e fëmijëve në nivel bashkie
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave



## I. Hyrje

Sot, shoqëria shqiptare përballlet me probleme të mprehta sociale si papunësia, lëvizja e pakontrolluar e popullsisë, emigracioni, kriminaliteti, prishja e familjeve tradicionale, rritja e numrit të divorceve, e numrit të fëmijëve jetimë dhe të braktisur, etj.

Fenomeni i braktisjes së fëmijëve ka ekzistuar dhe më parë, por jo në dimensionet e sotme. Në të kaluarën kjo dukuri shihej rrallë për shkak të karakterit patriarkal të familjes, mentalitetit të shoqërisë, por dhe pasojave që sillte braktisja e fëmijëve për personat përgjegjës. Në shoqërinë tonë ashtu si në çdo shoqëri tjetër, jetimët biologjikë e socialë, pra fëmijët të cilët nuk kanë prindër apo nuk kanë kujdesin e duhur të tyre për arsye të ndryshme si për shembull: I) vështirësive ekonomike në familje, II) dobësimin të bazave të familjeve që kanë çuar në rritjen e numrit të divorceve apo të braktisjes së tyre që në maternitet, etj. kanë nevojë për mbrojtje sociale të veçantë të shtetit dhe shoqërisë.

***Situata e braktisjes apo mos kujdesit ndaj fëmijëve jo domosdoshmërisht reflekton atë ç'ka parashikohet nga ligji.***

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon në nenin 54 të saj se fëmijët e të rinjtë kanë të drejtën e një mbrojtje të veçantë nga shteti. Posaçërisht fëmijët kanë të drejtën të jenë të mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi apo përdorimi për punë. Pra është detyrim shtetëror garantimi i një mbrojtje të veçantë ndaj fëmijëve në tërësi, e për më tepër ndaj fëmijëve në situata të veçanta e në nevojë për kujdes.

Nga ana tjetër, legjislacioni shqiptar, shprehimisht neni 5 i Kodit të Familjes të Republikës së Shqipërisë, sanksionon të drejtën e çdo fëmije për një zhvillim të plotë dhe harmonik të personalitetit, për t'u rritur në një mjedis familjar, atmosferë gëzimi, dashurie dhe mirëkuptimi.

### **Qëllimi i studimit**

Studimi u realizua nga SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri në kuadër të fushatës advokuese “Unë Vlej” dhe me ekspertizën e profesionistëve të organizatës “Fëmijët SOT”.

“Unë vlej” është një projekt advokues i SOS Fshatrave të Fëmijëve Shqipëri i cili ka nisur në 2009 dhe ka si qëllim ndryshimin e praktikave dhe politikave për fëmijët në kujdes.

Mesazhi kyç i fushatës “UNË VLEJ” është shtrirja e moshës në kujdes publik nga 15 deri në 18 vjeç.

***Kjo analizë synon të jetë sa një vështrim mbi politikat e mbrojtjes shoqërore e posaçërisht të jetimëve dhe ngritja e shërbimeve për këtë kategori, aq një analizë ligjore për të arritur në rekomandime të mundshme për përmirësimin e sistemit.***

Metodika e përdorur për realizimin e këtij studimi ishte ajo e analizës ligjore të akteve e politikave në fuqi, e intervistave me disa aktorë të rëndësishëm politikëbërës e zbatues në vend, si dhe përdorimi i të dhënave sasiore që janë të vlefshme në vend. Më konkretisht, analiza është bazuar kryesisht në:



- kuadrin ligjor e penal në Republikën e Shqipërisë.
- statistika të institucioneve qendrore
- krahasime e përqasje të mundshme të legjislacionit vendas me atë të vendeve të BE-së dhe *acquis* në fushën sociale
- përfundime dhe rekomandime për përmirësimin e përqasjen e legjislacionit mbi përfituesit e statusit të jetimit.
- Të dhënat nga intervistat e zhvilluara me fëmijët të cilët përgatiten për të dalë nga kujdesi rezidencial publik nga institucionet rezidenciale në Shkodër dhe në Tiranë (institucionet publike të grupmoshës 6-15 vjeç), në kuadër të një studimi të gjerë të realizuar nga SOS Fshatrat e Fëmijëve të quajtur “Kërkim Midis Bashkëmoshatarëve” (shiko: Literatura)

Në studim janë marrë në analizë të dhëna të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSShB), Shërbimit Social Shtetëror (ShSSH), OJF-ve që trajtojnë problematikat e kësaj kategorie të fëmijëve, kryesisht të Shoqatës së Jetimëve, Amnesty International, SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri, UNICEF. Janë shfrytëzuar burime nga faqet e internetit si dhe nga takimet e realizuara në këto institucione.

Përgjatë punimit janë përdorur statistika të cilat ndihmojnë analizën dhe dhënien e sugjerimeve. Modelet krahasuese të vendeve të tjera janë gjithashtu të rëndësishme me qëllim ofrimin e sugjerimeve mbështetur edhe në praktikat më të mira.

Studimi u realizua gjatë Shtator – Dhjetor 2011 dhe një azhurnim të të dhënave gjatë vitit 2012.

Për realizimin e këtij studimi u zhvilluan edhe disa takime me: Znj. Albana Shtylla, Drejtore e Drejtorisë Juridike, Znj. Denada Seferi, Drejtore e Politikave të Shërbimeve Sociale, Z. Mihal Naço, Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror, Znj. Arkida Hysenaj, Drejtore e Inspektimit të Standardeve në SHSSH, Z. Gazmend Zita shef sektori në Drejtorinë e Inspektimit të Standardeve për fëmijë në SHSSH, Znj. Ilda Poda, Specialiste në Drejtorinë e Politikave të Shërbimeve Sociale, Z. Kadri Aliaj Presidenti Shoqatës Kombëtare për Jetimët, të cilët i falënderojmë për kontributin e tyre.

Sugjerimet e kësaj analize do të ndahen me OJF të tjera, ku do të merren idetë dhe mendimi i tyre me qëllim përmirësime të mundshme.



## II. Pjesa e parë - Ligji për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

---

Më datë 04.11.2010, u miratua Ligji kuadër nr. 10347 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”. Ky ligj synon të krijojë kushtet e përshtatshme për hartimin dhe zbatimin e politikave që ndikojnë mbi të drejtat e fëmijëve, duke i përshtatur ato me standardet ndërkombëtare. Gjithashtu, ky ligj për herë të parë realizon vendosjen e një sistemi efektiv vëzhgimi dhe raportimi lidhur me realizimin e të drejtave të fëmijëve në nivel qendror dhe vendor. Ligji parashikon mekanizmat institucionalë, të cilat do të jenë përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji dhe garant për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në përgjithësi.

Konkretisht, në nenin 32 të projektligjit listohen mekanizmat në nivel qendror dhe në nivel vendor.

Së pari, në ligj parashikohet ngritja dhe funksionimi i **Këshillit Kombëtar për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës**, i cili do të jetë organ këshillimor dhe që do të ketë në përbërje të tij 9 anëtarë, të cilët do të jenë përfaqësues të ekzekutivit, të pushtetit vendor dhe të shoqërisë civile. Gjithashtu, parashikohet se pranë Këshillit do të ngrihen **komitete teknike**, të cilat do të kenë funksion ndihmës për Këshillin, kryesisht, në lidhje me vendimet që do të duhet të ndërmerren ky organ.

Së dyti, në ligj parashikohet ngritja dhe funksionimi i një institucioni qendror, i cili është **Agjencia Shtetërore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës**. Ky institucion do të funksionojë nën varësinë e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

**Agjencia Shtetërore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës** është krijuar dhe tashmë funksionon në bazë të detyrave të mëposhtme:

- a) **ekzekutuese** në drejtim të monitorimit të zbatimit të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi, strategjive dhe politikave në fushën e të drejtave të fëmijëve;
- b) **propozuese** për udhëzime metodologjike për njësitë e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës në organet e qeverisjes vendore;
- c) **mbështetëse teknike**, për strukturat e organeve të qeverisjes qendrore dhe vendore, si dhe për organizatat jofitimprurëse, që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;
- d) **koordinuese** me të gjitha strukturat e qeverisjes qendrore dhe vendore për përgatitjen e raporteve, informacioneve dhe statistikave për gjendjen e zbatimit të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, si dhe
- e) **ndëshkuese** ndaj subjekteve të cilat shkelin dispozitat e ligjit.

Për të kompletuar kuadrin institucional, me qëllim zbatimin efektiv të ligjit, parashikohet ngritja e **njesisë për të drejtat e fëmijëve në nivel qarku dhe bashkie apo komuna**. Ngritja dhe funksionimi i këtyre njësive do të bëjë të mundur zbatimin dhe monitorimin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në terren, pra nga baza e duke vazhduar vertikalisht drejt ekzekutivit. Në respektim të parimit të autonomisë lokale, ligji parashikon funksionimin e këtyre njësive brenda organizimit administrativ të strukturave përkatëse të pushtetit lokal, me detyrat e parashikuara në këtë ligj.



Në bashkëpunim me pushtetin vendor dhe me mbështetjen e donatorëve janë ngritur *Njësitë për të Drejtat e Fëmijëve në nivel qarku (NJDF) dhe njësitë për mbrojtjen e fëmijëve në nivel bashkie (NJMF)*. Në bashkëpunim me shoqërinë civile, mbështetur nga UNICEF, janë ngritur Observatorët e të drejtave të fëmijëve në nivel qarku.

**1. NJDF** janë ngritur brenda strukturës administrative të qarkut dhe ka për detyrë:

- a. **Të identifikojë dhe koordinojë** referimin e rasteve të shkeljeve apo abuzimit, keqpërdorimit të të drejtave të fëmijëve në nivel rajonal.
- b. **Të vëzhgojë dhe vlerësojë** mënyrën e zbatimit të ligjeve dhe politikave që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, në nivel rajonal.
- c. **Të bashkëpunojë dhe të shkëmbejë** informacion me zyrën e Statistikave, Drejtorinë Rajonale të Shëndetit Parësor, Drejtorinë Rajonale të Arsimit, Zyrën e Regjistrimit të Gjendjes Civile, Seksionin e Ndihmës Ekonomike dhe pagesës së paaftësisë në Bashki dhe Komuna si edhe çdo institucion tjetër të qeverisjes vendore apo shoqërisë civile.
- d. **Të raportojë** në Këshillin e Qarkut për ecurinë e procesit të respektimit të të drejtave të fëmijëve në rajon. Aktualisht këto njësi funksionojnë në 6 qarqe (Kukës, Vlorë, Korçë, Tiranë, Durrës, Elbasan).

**2. NJMF** është ngritur brenda strukturave administrative të shërbimeve sociale në bashki në bazë të një memorandumit mirëkuptimi mes bashkisë përkatëse dhe OJF-së zbatuese. Në kuadër të këtij Memorandumi, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve financohet në mënyrë të përbashkët nga bashkia, UNICEF dhe OJF për një periudhë kalimtare 3-vjeçare. Në përfundim të kësaj periudhe njësia do të financohet dhe do të administrohet vetëm nga bashkia. Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve kanë këto funksione kryesore:

- a. **Identifikimin e menaxhimin** e rasteve në mënyrë multidisiplinare.
- b. **Vlerësimin, monitorimin** e situatës së familjeve dhe fëmijëve në rrezik.
- c. **Koordinimin** e mbrojtjes dhe referimin e rasteve në nivel lokal.
- d. **Sensibilizimin** e komunitetit.

Aktualisht, këto njësi funksionojnë në 17 bashki (Elbasan, Pogradec, Korçë, Fier, Gjirokastrë, Kukës, Kuçovë, Durrës, Sarandë, Shkodër, Peshkopi, Lezhë). Kjo nismë zbatohet në bashkëpunim me organizatën Terres des Hommes.

Gjatë vitit 2011 njësitë për mbrojtjen e fëmijëve kanë kontribuar dhe kanë marrë pjesë në mënyrë aktive për sensibilizimin e komunitetit kundër shfrytëzimit të fëmijëve për punë, fëmijëve në risk trafikimi dhe fëmijëve me probleme sociale.

Gjithashtu, është hartuar **protokolli i punës së njësive në bashki**, për mbrojtjen e fëmijëve. Protokollin e kapitujt e tij parashikon:

- **Detyrat** e punonjësit të mbrojtjes së fëmijëve në bashki;
- **Identifikimin** dhe menaxhimin e rastit;
- **Vlerësimin** i situatës së fëmijës nëpërmjet përcaktimit të nivelit të rrezikut;
- **Hartimin** e Planit Individual të Mbrojtjes së Fëmijës dhe zbatimi i tij.

**3. Një tjetër strukturë e shoqërisë civile që plotëson sistemin e mbrojtjes së fëmijëve është Observatori i të Drejtave të Fëmijës.** Kjo është një iniciativë e Aleancës për Fëmijë dhe pushtetit vendor, e mbështetur nga UNICEF, që synon të kontribuojë në analizën e ndikimit





të politikave sociale dhe ekonomike në realizimin e të drejtave të fëmijëve. Observatori është një mekanizëm që ndihmon rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të shoqërisë, familjes, komunitetit dhe vetë fëmijës, mbi detyrimet e tyre për realizimin e të drejtave të fëmijëve. Aktualisht observatorët janë krijuar në 6 qarqe: Kukës, Durrës, Elbasan, Korçë, Shkodër dhe Dibër.

Kjo panoramë tregon për strukturat e ngritura shtetërore për të adresuar çështjet e fëmijëve. Këto struktura të përmendura më lart kanë për detyrë që ndër të tjera të adresojnë pashmangshmërisht problematikat me të cilat përballen fëmijët jetimë. Një sërë çështjesh adresohen sot në bazë të legjislacionit në fuqi dhe një sërë lehtësish i ofrohen kësaj kategorie në vend. Pavarësisht kësaj kjo kategori përjeton një sërë problemesh, qoftë në periudhën kur institucionet shtetërore ofrojnë përkujdesje për ta (një adresim programatik ky i tejkaluar sipas ligjit dhe strategjive) apo edhe kur kjo përkujdesje e drejtpërdrejtë përfundon dhe jetimët bëhen subjekt i lehtësimeve të tjera më të pakta sipas legjislacionit.



### III. Pjesa e Dytë - Shërbimi publik dhe jopublik. Situata e fëmijëve në institucione

---

Në politikat e mbrojtjes shoqërore vend të rëndësishëm zë mbrojtja e jetimëve dhe ngritja e shërbimeve alternative për këtë kategori:

#### Institucionet e përkujdeset shoqëror publik dhe jopublik.

---

Aktualisht janë 9 (nëntë) institucione publike rezidenciale dhe 18 institucione jopublike rezidenciale të përkujdesit shoqëror që trajtojnë fëmijë jetimë dhe të braktisur. Në këto institucione trajtohen fëmijë të moshës nga 0-15 vjeç. Misioni kryesor i këtyre institucioneve është kthimi i fëmijëve në familjen biologjike ose gjetja e një familjeje kujdestare apo birësuese. Institucionet rezidenciale për fëmijë janë institucione kombëtare, të financuara nga buxheti i shtetit dhe donatorë të ndryshëm në masën 20-35 % të buxhetit të siguruar nga shteti.

Aktualisht shërbimi social në Shqipëri ofrohet në dy forma:

- Shërbim publik
- Shërbim jopublik

#### Shërbimi publik

---

Shërbimi Publik për fëmijë ofrohet në 19 Institucione të Përkujdesit Shoqëror, si më poshtë:

- 6 shtëpi fëmije parashkollore (0-6 vjeç) në Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër dhe Korçë (ditore dhe rezidenciale);
- 3 shtëpi fëmije shkollore (6-15 vjeç) në Tiranë, Sarandë dhe Shkodër;
- 6 Qendra Zhvillimi në Berat, Durrës, Shkodër, Korçë, Tiranë, Vlorë;
- 2 Qendra Ditore Riaftësimit në Lezhë dhe në Korçë
- 1 Qendër e Pritjes Viktimave Trafikimit në Tiranë;
- 1 Qendër Polivalente për Persona në nevojë

Edhe pse të tilla institucione funksionojnë në vend, duhet theksuar se parimi i theksuar nga Strategjia e Mbrojtjes Sociale është: **JO TË NDËRTOJMË INSTITUCIONE POR TË NGREMË SHËRBIME.** Pra, modeli i këtyre institucioneve do duhet sa më parë të adresohet në këndvështrim të këtij parimi.

Kategoritë e fëmijëve që jetojnë, edukohen dhe trajtohen në institucionet e përkujdesit social, sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin nr. 9355 “Për ndihmën ekonomike dhe shërbimet shoqërore” i ndryshuar, janë:

- Fëmijë jetimë biologjike, të cilët i kanë humbur të dy prindërit
- Fëmijë të braktisur që në lindje/jashtë martese
- Fëmijë nga familje me probleme sociale, kushte të vështira ekonomike



- Prindër me paaftësi mendore dhe fizike dhe të sëmurë Familje të dezinteguara për shkak të divorcit, vdekjes së një prindi, rimartesës ose largimit në emigracion të prindit tjetër
- Prindi/prindërit të burgosur
- Familje njëprindërore

#### **Situata e nevojave të fëmijëve në risk:**

Në institucionet publike rezidenciale dhe ditore trajtohen 400 fëmijë të moshës 0-18 vjeç, në ato jopublike 600 fëmijë, nga të cilët vetëm në qendrat ditore publike trajtohen 70 fëmijë dhe në qendrat ditore jopublike rreth 1609 fëmijë.

#### **Situata e fëmijëve në institucione:**

Në shpërndarjen e fëmijëve sipas tipit të institucionit tregohet se peshën më të madhe e zënë fëmijët e moshës 6 – 15 vjeç,<sup>1</sup> të cilët përbëjnë 54% të fëmijëve të institucionalizuar. Analiza e të dhënave mbi numrin e fëmijëve që janë futur në institucione në periudhën 2000-2008 tregon se mesatarisht 65% e fëmijëve të institucionalizuar vijnë nga familja, kurse rreth 35% e tyre janë fëmijë të braktisur.<sup>1</sup>

##### ***a. Fëmijë jetimë biologjikë, të cilëve i kanë humbur të dy prindërit***

Nga 400 fëmijë të vendosur në IPSH, 3% e fëmijëve janë jetimë biologjike. Karakteristike është fakti që kjo kategori është më e pranishme të fëmijët e grup-moshës 6-14 vjeç. Sipas të dhënave numri i fëmijëve jetimë ose me një prind është në rritje për shkak të rritjes së aksidenteve, vdekjeve natyrale, divorceve, braktisjes etj.

##### ***b. Fëmijë të braktisur që në lindje/ilegjitime***

Nisur nga studimi i kërkesave për vendosjen e fëmijëve në IPSH, vihet re se fëmijët e braktisur vijnë nga marrëdhëniet jashtëmartesore të personave të cilët kanë një lidhje martesore tjetër dhe për arsye të ndryshme nuk mund të krijojnë familje. Kjo kategori përbën 16% të numrit total të fëmijëve në institucionet 0-6 vjeç.

##### ***c. Fëmijë nga familje me probleme sociale, kushte të vështira ekonomike***

Një pjesë e fëmijëve janë vendosur në institucione për shkak të dezintegrimit të familjes si rezultat i divorcit, sëmundjes, vdekjes së njërit prind, burgosjes së prindit, rimartesës etj. Familja shqiptare tradicionalisht e qëndrueshme me rregulla të forta dhe një profil të theksuar patriarkal, në kushtet e sotme, përballë sfidave të reja të jetesës, po përjeton simptomat e krizës dhe dezintegrimit.

Dezintegrimi i familjes për shkak të faktorëve të mësipërm, shoqërohet në mjaft raste me reduktimin e të ardhurave, përkeqësimin e kushteve të jetesës (strehimi, papunësi dhe varfëri). Situata e vështirë ekonomike e familjes/prindit kujdestar pas dezintegrimit të familjes, është një faktor që ka peshë të konsiderueshme për vendosjen e fëmijëve në institucione.

---

<sup>1</sup> Të dhënat janë marrë nga raportet vjetore të analizës së punës të Shërbimit Social Shtetëror e veçanërisht të Drejtorisë Monitorimit të Standardeve të Perkujudesit Shoqëror për fëmijët

2. Studimi; Kujdesi Rezidencial



Përfundimet e disa studimeve të UNICEF tregojnë që ekzistojnë dy arsye të dukshme pse prindërit braktisin fëmijët e tyre në institucionet publike:<sup>2</sup> varfëria dhe fakti që institucionet ofrojnë edukim dhe ushqim. Prindërit janë të varfër dhe të paaftë për të mbështetur fëmijët e tyre.<sup>2</sup>

#### ***d. Prindër me aftësi të kufizuar intelektuale apo fizik.***

5% e fëmijëve për të tre grupmoshat kanë një ose të dy prindërit me sëmundje mendore ose paaftësi. Në institucionet e fëmijëve 0-6 vjeç rreth 6,5% e fëmijëve ose 11 nga 159 fëmijë kanë njërin prind që vuan nga sëmundje mendore. Në institucionet publike për fëmijë 6-14 vjeç nga 191 fëmijë, rreth 3,5% raportohen me njërin ose të dy prindërit me aftësi të kufizuar intelektuale apo fizike etj.

#### ***e. Familje të dezinteguara***

Familje të dezinteguara për shkak të divorcit, vdekjes së një prindi, rimartesës ose largimit në emigracion të prindit tjetër.

Në institucionet publike për të 3 grupmoshat rreth 14 % e fëmijëve vijnë nga familje me prindër të divorcuar. Fëmijët me prindër të divorcuar në IPSH 0-6 vjeç zënë 7% të numrit total të përfituesve në këto institucione, kurse në institucionet 6-16 vjeç, ata zënë rreth 20% të numrit total të fëmijëve. Nga intervistimi i punonjësëve sociale dhe një grupi të fëmijëve me prindër të divorcuar në institucione, evidentohen disa elemente të rëndësishëm:

Pas divorcit disa nga nënat rimartohen me burra të divorcuar të cilët nuk pranojnë për shkak të kushteve ekonomike, por edhe mentalitetit konservator, të kujdesen për fëmijët e sjellë nga gruaja; disa nga prindërit e divorcuar largohen në emigracion duke i lënë fëmijët nën kujdesin e të afërmeve ose duke i vendosur në institucione.

Nga analiza e të dhënave mbi divorcet në Shqipëri<sup>3</sup> evidentohen këto shifra:

- Prindi/prindërit të burgosur - 7% kanë njërin prind në burg
- Familje njëprindërore - Fëmijët me një prind zënë peshën më të madhe në kategoritë e fëmijëve të vendosur në institucione (3% e fëmijëve). Gati 80 % e tyre janë fëmijë të moshës 6-14 vjeç, 15 % fëmijë të moshës 0-3 vjeç dhe 5% fëmijë të grupmoshës 4-6 vjeç.

Analiza krahasuese e statusit social të fëmijëve sipas ndarjes së institucioneve evidenton disa karakteristika:

- Fëmijët me prindër të divorcuar në IPSH 0-6 vjeç zënë 7% të nr. total të përfituesve në IPSH; kurse në IPSH 6-16 vjeç ata zënë rreth 20% të fëmijëve.
- Nga kjo analizë krahasuese vihet re se në të gjitha IPSH, rreth 80 % janë fëmijë që vijnë nga familje me prindër të divorcuar, me probleme sociale, të burgosur, të larguar në emigracion, etj. Vetëm 20% (numri është krejtësisht në rënie) janë jetimë biologjikë.

<sup>2</sup> UNICEF, Analiza e Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve në Shqipëri, Prill 2007

<sup>3</sup> INSTAT



***Shërbimi Publik paraqitet i vjetruar, rezidencial, rehabilitues dhe më pak parandalues. Peshën kryesore të shërbimit rezidencial e kanë institucionet publike të shtetit dhe donatorë kryesisht ndërkombëtarë. Shërbimi jorezidencial dominohet nga shërbimi që japin kryesisht OJF vendase.***

## Shërbimi jopublik

---

Shërbimi jopublik ofrohet nga OJF-te. Janë liçensuar 118 OJF të cilat ofrojnë shërbime sociale. Marrëdhëniet me shoqërinë civile janë institucionalizuar dhe operojnë në fushën e përkujdeset shoqëror në dy aspekte kryesore:

1. Mbështetjen e Institucioneve të përkujdesit me mjete materiale, ushqime, trainim stafi, rikonstruksion godinash.
2. Ngritjen dhe menaxhimin me fondet e tyre të institucioneve të përkujdesit për kategoritë në nevojë.

OJF-të që kanë krijuar dhe menaxhojnë struktura të reja të shërbimit social për fëmijët në nevojë janë rreth 28 qendra ditore dhe 18 qendra rezidenciale. Fokusi kryesor i tyre është trajtimi i kategorisë së fëmijëve jetimë dhe të braktisur, fëmijë me aftësi të kufizuara. Në këtë mori shërbimesh dhe shoqatash të liçencuara, nga raportet 6 mujore të OJF-ve të liçencuara, të cilat raportojnë në SHSSH, përfitues të shërbimeve/projekteve të ndryshme janë rreth 6000 fëmijë.

Një nga alternativat e ofrimit të përkujdesit për fëmijë është birësimi. Sipas Komitetit Shtetëror të Birësimeve mesatarisht 60-70 fëmijë kalojnë në procesin ligjor të birësimit, brenda vendit apo ndërkombëtar, në 1 vit. Numri i fëmijëve jetimë është rreth 16 mijë fëmijë pa ose me një prind që jetojnë në familje ose në komunitet.

Sipas të dhënave nga MPÇSSH, është ndërmarrë iniciativa për reformën aktuale të shërbimeve sociale. Reforma e shërbimeve sociale është harmonizuar me procesin e **decentralizimit** të kompetencave të pushtetit vendor, duke vlerësuar se strukturat territoriale dhe pushteti vendor, të cilat po bashkëpunojnë për realizimin sa më me efikasitet të këtij procesi, dhe paralelisht me këtë, me drejtimin e dytë dhe po kaq të rëndësishëm me **Deinstitutionalizimin**.

## Reforma

---

### **Decentralizimi**

Filozofia e decentralizimit bazohet në kombinimin e të ardhurave nga burime të ndryshme: me fondet e buxhetit të shtetit dhe fondin e taksave mbledhur nga pushteti vendor do të realizohen shërbime sa më pranë klientit, pra që shërbimi të shkojë të klienti dhe jo klienti të kërkojë shërbimin.

Në këtë kuadër, në vitin 2009, janë transferuar në pushtetin vendor 19 shërbime rezidenciale kundrejt 26 gjithsej. Shërbimet mbështeten me fonde, ekspertizë dhe monitorohet performanca e tyre.



MPÇSSHB në bashkëpunim me Njësinë e Projektit “Shpërndarja e Shërbimeve Sociale në Shqipëri” ka ngritur 45 shërbime të reja me bazë komunitare (projekt i Bankës Botërore (2004-2007). Nga 45 shërbime, 17 prej tyre janë Qendra Ditore për fëmijët. Këto shërbime, sipas burimeve të MPÇSSHB, ishin një alternativë mjaft e mirë për mos institucionalizimin e fëmijëve, ndaj edhe politika e shërbimeve sociale ishte orientuar drejt tyre. Por problemi kryesor, është se në përfundim të mbështetjes financiare nga Projekti i Bankës Botërore, do të realizohej kalimi i tyre nëpërmjet një marrëveshje mes Pushtetit Vendor dhe Shoqatës për vazhdimin e funksionimit të këtyre shërbimeve duke marrë financim nga Pushteti Vendor dhe nga burimet e shoqatës. Kjo praktikë dhe kjo marrëveshje nuk u zbatua asnjëherë dhe pothuaj 80 % e këtyre shërbimeve rezultojnë të jenë të mbyllura dhe vetëm 20 % e tyre kanë mundur të mbijetojnë me fondet e donatorëve të ndryshëm ose me ndonjë mbështetje nga buxheti i shtetit.

### Deinstitucionalizimi

Është një proces që ka filluar me disa eksperiencat të izoluara të udhëhequra nga MPÇSSHB dhe SHSSH në bashkëpunim me disa fondacione dhe rezultati është që aktualisht po funksionon në Shqipëri. Por nëse “dallëndyshet e para” po funksionojnë mjaft mirë pasi mbështeten akoma nga buxheti i shtetit, shtëpitë- familje të OJF-ve hasen me disa vështirësi financimi, pasi normalisht nuk mbështeten financiarisht nga shteti.

Ato pretendojnë që një formë e mirë do të jetë mbështetja nga fondet e Pushtetit vendor + Qendror, pasi shteti është i detyruar të financojë fëmijët me AK të cilët aktualisht trajtohen në këto qendra. Në fakt, edhe sipas burimeve të MPÇSSHB këtu ekziston një kontradiktë mes përfituesve jetimë me AK, të cilët aktualisht jetojnë në këto shtëpi-familje dhe fillimisht kanë qenë përfitues të shërbimeve publike dhe më pas janë transferuar në këto shtëpi-familje jopublike. Normalisht, moshën e tyre madhore, nuk duhet të jetë justifikimi i vetëm për trajtimin e tyre të njëanshëm.

Kështu, janë ngritur 2 shtëpi familje për fëmijët jetimë në Durrës dhe 5 shtëpi për PAK në Shkodër ku trajtohen 60 fëmijë me PAK.

Kjo është një nga eksperiencat më të mira e cila do të përmirësojë ndjeshëm cilësinë e jetesës së fëmijëve jetimë dhe me probleme social-ekonomike të cilët do të trajtohen me standarde më të larta dhe bashkëkohore. Por ky proces duhet të vazhdojë dhe të përfshijë të gjithë institucionet e përkujdesit shoqëror.

Ndërkaq, një mundësi alternative për shërbimin institucional është edhe **Kujdestaria e Përkohshme** për fëmijët pa kujdes prindëror. Kjo praktikë po zbatohet në dy rajone pilot dhe ka dhënë rezultate të dukshme. Kujdestaria e përkohshme, e cila është edhe një nga zgjidhjet më optimale për fëmijët të cilët jetojnë në familje me probleme sociale dhe ekonomike, ose fëmijë të lindur jashtë martesë, nënat e të cilëve kanë probleme ekonomike dhe konflikte me familjet e origjinës. Sistemimi i tyre në një familje, e cila është e gatshme t’i mirëpresë dhe t’i mbajë në gjirin e saj për aq kohë sa familjet dhe prindërit kanë këto probleme, është një alternativë e vlefshme dhe më e natyrshme për fëmijët. Ky shërbim kujdestarie do të mbështetet nga shteti dhe për këtë qëllim janë bërë edhe përmirësime ligjore. Kjo është parashikuar në ndryshimin e ligjit 9355 “Për ndihmën ekonomike dhe shërbimet shoqërore” që kjo familje kujdestare do të mbështetet nga buxheti i shtetit.



Për garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë së shërbimeve, Ministria ka hartuar një udhëzim ku garantohet mbështetja e politikave të reja dhe zhvillimi i shërbimeve komunitare për:

- krijimin e një sistemi komunitar shërbimesh, ku individi dhe grupet në nevojë mbështeten në mjedisin ku ata jetojnë, duke respektuar, personalitetin, vlerat, aftësitë, preferencat dhe burimet e tij;
- kalimin gradual nga shërbime rezidenciale në shërbime komunitare; Zgjerimin e llojshmërisë së shërbimeve sociale;
- rritjen e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile për ofrimin e shërbimeve komunitare;
- transformimin e shërbimeve ekzistuese në modele të reja me pikësnyim përmirësimin e shërbimeve sociale;
- shpërndarjen e shërbimeve sipas gjeografisë së nevojave,
- monitorimin e standardeve të shërbimeve sociale në institucionet publike dhe jopublike dhe hartimi i rregulloreve në bazë të standardeve të reja;
- trajtimi i përkohshëm në institucione rezidenciale (institucione të përkujdesit social, qendra zhvillimi)
- trajtimi jorezidencial (modele dhe regjime të reja më pranë përfituesve) duke i dhënë përparësi të dytave pasi janë më pranë ambientit natyral të fëmijëve në nevojë, më të arritshme dhe të prekshme nga përfituesit si dhe më pak të kushtueshme.

Trajtimi rezidencial i fëmijëve do të ofrohet si alternativë e fundit, veçanërisht për fëmijët jetimë biologjikë dhe socialë, fëmijët me aftësi të kufizuar intelektuale e fizike me shkallë të lartë paaftësie

- parandalimin e institucionalizimeve të panevojshme;
- shkurtrimin e kohës së qëndrimit të përfituesve në qendrat rezidenciale nëpërmjet:
  - kthimit të fëmijëve në familjen biologjike;
  - vendosjes së tyre në një familje kujdestare;
  - vendosjes në familjen birësuese;

***Rezultati i këtyre masave ishte reduktimi i institucionalizimeve në 20% nga viti 2005 deri në vitin 2010.***

***Në planin e veprimit të MPÇSSHB, në kuadër të reformës së shërbimeve sociale, janë propozuar alternativat për të ardhmen e shërbimeve sociale kryesisht për fëmijë.***

Synimi i strukturave të Shërbimit Social Shtetëror është që, në partneritet me shoqërinë civile, pushtetin vendor dhe sektorin e OJF-ve, të aplikohen alternativat e mundshme për të zhvilluar më tej shërbimet shoqërore duke u fokusuar në këto drejtime:

- Krijimi i shërbimeve për familjen;
- Ofrimi i shërbimeve riintegruese dhe rehabilituese
- Shpërndarje gjeografike më e drejtë e IPSH-ve
- Qendra Ditore për mbështetje dhe trajtim psiko-social, edukim dhe këshillim të kategorive të ndryshme të fëmijëve.



- Qendra pritëse (strehëza) për pritjen dhe strehimin e përkohshëm të fëmijëve të riatdhesuar, të larguar pa prindërit në emigracion etj
- Qendra rehabilitimi për fëmijët dhe të rinjtë e droguar dhe të alkoolizuar, për trajtimin psiko-social, këshillim, formim profesional, rehabilitim dhe riintegrim në jetën normale.
- Shtëpi-familje dhe qendra ditore për trajtimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe jetimë të cilët lënë institucionet e përkujdesit, për fëmijët që vijnë nga familje me probleme sociale etj.
- Qendra këshillimi ligjore për probleme juridike, për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve jetimë ose me probleme sociale.
- Qendra polivalente, të cilat ofrojnë një gamë të gjerë të shërbimeve si këshillim, konsulencë juridike, mbështetje psikosociale, asistencë në familje, kurse formimi trajnimi, informacion asistencë për zgjidhjen e situatave të jashtëzakonshme të personave në rrezik, vuajtje etj.
- Birësimi – alternativa më e mirë për fëmijët e braktisur dhe me prindër të panjohur
- Krijimi i laboratorëve të ergoterapisë në të gjitha institucionet e trajtimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar.
- Krijimi i apartamenteve sociale për të rinjtë mbi 15 vjeç të cilët lënë institucionet e përkujdesit shoqëror dhe që nuk kanë një alternativë.

Aktualisht, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta është duke zbatuar një plan veprimi për transformimin e institucionit “Zyber Hallulli” në Tiranë, i cili në vitet në vazhdim do të pasohet nga Transformimi i qendrave rezidenciale në Sarandë, Shkodër, Tiranë, Vlorë, Korçë.

Ky plan ka filluar me ndryshimet e nevojshme infrastrukturore.

Ky proces mbështetet nga UNICEF Shqipëri dhe është pjesë e Planit të Veprimit të Fëmijëve të vitit 2012 -2015.

Por duke u bazuar në situatën aktuale, Pas një analize të gjerë situatës së fëmijëve të institucionalizuar, mund të arrihet në përfundimin se fëmijët e institucionalizuar janë ende shumë dhe pak bëhet për parandalimin e institucionalizimit të tyre. Këto institucione nuk kanë staf të kualifikuar për trajtimin e fëmijëve dhe shpeshherë nuk ka qëndrueshmëri administrative të këtyre stafeve.

Ajo ç’ka është për t’u theksuar është se shpesh herë fëmijët e institucioneve publike kryesisht, pësojnë deformime të personalitetit dhe sjelljes për shkak të qëndrimit të gjatë në institucione. Reforma që është ndërmarrë mbi deinstitucionalizimin është një reformë shumë e rëndësishme nëse ajo do të vijojë në të gjitha institucionet publike.

Në zbatim të Standardeve të përkujdesit shoqëror, është shumë i rëndësishëm zbatimi i tyre me përpikmëri dhe veçanërisht hartimi i planeve të përkujdesjes ku komponenti më i rëndësishëm është plani mbi largimin nga përkujdesja publike. Punonjësit social të institucioneve, për shkak edhe të inspektimeve të shumta dhe trysnisë së ushtruar nga Shërbimi Social Shtetëror dhe Drejtoria e Inspektimit të Standardeve, ka realizuar planet e përkujdesjes për çdo fëmijë, por rezulton (raportet e inspektimeve nga SHSSH – 2008 – 2009 – 2010) se këto plane pothuaj nuk zbatohen dhe kryesisht fëmijët që janë braktisur nga





familja dhe që janë në moshë më të rritur e kanë shumë të vështirë të përballojnë jetesën jashtë mureve të këtyre institucioneve.\*<sup>5</sup> 4

Me poshtë pasqyrohen disa të dhëna mbi:

1. Numri i fëmijëve në përkujdes
2. Përgatitja për të dalë nga përkujdesi
3. Përfitimet pasi del nga përkujdesi

Sipas raporteve të SHSSH rezulton se fëmijët jetimë që trajtohen në institucionet publike dhe jo publike janë rreth 582 fëmijë – rezidenciale nga të cilët :

- 238 fëmijë (ne 9 institucionet publike)
- 344 fëmijë (në 18 institucionet jopublike OJF- të);

**Nga këto fëmije jetimë socialë, domethënë fëmije të cilët vijnë nga familjet me probleme social ekonomike me mundësi riintegrimi në familjen e tyre, janë :**

- 172 fëmije ne institucionet publike;
- 258 fëmije ne institucionet jopublike

**Fëmijë që përgatiten për të dalë nga institucionet publike janë 13 fëmijë;**

- 4 - fëmijë nga Zyber Hallulli;
- 6 - fëmijë nga Shtëpia e fëmijës 6-15 vjeç Shkodër
- 3 - fëmijë nga Shtëpia e fëmijës 6-15 vjeç Sarandë.

Për të patur shembuj konkretë gjatë vitit 2010, plani i përkujdesjes mbi këta 13 fëmijë që largohen nga institucionet përkatëse, rezulton se destinacioni i tyre është transferimi në Qendrën TAG (Hope for the World), vazhdimi i arsimit parauniversitar, gjithashtu kjo qendër TAG për fëmijët që nuk e përfitojnë Statusin e Jetimit dhe që nuk kanë mundësi për tu kthyer në familjen biologjike, mbulon ushqimin dhe akomodimin në konvikt të tyre.

Në lidhje me fëmijët që trajtohen në Institucionet jopublike, tipologjia e shërbimit të tyre në institucionet rezidenciale qëndrimi i fëmijëve është deri në moshën 18 vjeç, pa u bazuar në ligj, por duke patur parasysh që nuk braktisen e nuk hidhen në mes të rrugës. Institucionet jo publike të cilat trajtojnë fëmijë jashtë përkujdesit shtetëror, janë si më poshtë:

- Qendra TAG Tiranë.
- SOS Fshati i fëmijëve Tiranë,
- Betania Bubq Fushë Krujë,
- Vatër e Ngrohtë Gjirokastër,
- Papa Giovanni XXIII Shkodër,
- Shtëpia e Shpresës Elbasan
- Orët fatlume Elbasan ( Shtëpia për vajza)
- Kenedy Korçë

Këto janë institucione që ofrojnë shërbime për fëmijë në formën e Shtëpi-familje.

<sup>5</sup> Raportet e inspektimeve nga SHSSH – 2008 – 2009 – 2010 - marrë nga SHSSH.



Një pjesë e vogël e tyre ofrojnë shërbime për fëmijët të cilët dalin nga përkujdesi alternativ të grupmoshës 16-18 vjeç. Si të tillë mund të përmendim SOS Fshatrat e Fëmijëve nëpërmjet programeve rinore SOS (26 të rinj), Shpresë për Botën Tiranë (20 të rinj), Maddonina Della Grappa (14 vajza)

Këto modele janë praktika të mira të cilat mund të replikohen edhe në institucionet publike të kujdesit. Disa prej tyre kanë edhe një bazë të mirë të manualeve dhe dokumentave që mund të përdoren për modelin e shtëpisë – familje për këtë kategori.

Ndërkohë që ndjekja e ecurisë së fëmijës pasi del nga institucioni ka mangësi të mëdha. Sigurisht përgjegjësia kryesore është e strukturave të njësisë së qeverisjes vendore e cila ngarkohet me detyrimin për të zbatuar kërkesat normative të ligjit mbi Statusin e Jetimit.



#### IV. Pjesa e tretë – Ligji për statusin e jetimit. Problematikat.

---

Statusi i jetimit jepet në zbatim të një Ligji Nr. 8153, dt. 31.10.1996. Statusin e jetimit e përfitojnë të gjithë personat me moshë nga 0-25 vjeç që kanë kaluar ose jo nëpër institucionet shtetërore apo private të përkujdesit shoqëror dhe që plotësojnë këto kritere.

- Janë të lindur jashtë martesë
- Nuk kanë gjallë asnjë nga prindërit
- U është hequr e drejta prindërore për të dy prindërit me vendim të formës së prerë të gjykatës, ose e njërit prind dhe prindi tjetër nuk jeton.
- Që braktisen nga të dy prindërit dhe nuk u njihet identiteti i tyre.

Neni 1 aktualisht përkufizohet vetëm te të ashtuquajturit “jetimë biologjikë” apo ata fëmijë dhe të rinj të cilët mund ta gëzojnë këtë të drejtë.

Nuk përkufizohen më gjerë fëmijët të cilët mund të kenë një prej prindërve dhe që për arsye të ndryshme i kanë vendosur fëmijët e tyre në kujdes alternativ. Është e nevojshme që ligji të përcaktojë më gjerë kategoritë e fëmijëve të cilët “janë pa kujdes prindëror” dhe jo të limitohet vetëm në kriteret e sipërpërmendura.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kushtet aktuale, kur shumica e fëmijëve në kujdes duket që vijnë prej familjeve me një prind apo në vështirësi social-ekonomike.

Statusi i jetimit jepet nga SHSSH-ja nga një komision specialistësh në nivel drejtorie në përbërje të të cilit është dhe një përfaqësues i Shoqatës së Jetimëve të Shqipërisë. Kjo shoqatë është themeluar vitin 1991 dhe ka si qëllim mbrojtjen e të drejtave të jetimëve dhe integrimin e tyre në komunitet. Kryetar i këtij Komisioni është Drejtor i Përgjithshëm i SHSSH-së. Ky komision mblidhet 1 herë në tre muaj. Personat që plotësojnë kriteret e mësipërme përfitojnë nga ky status edhe pasi kanë kaluar moshën 25 vjeç, nëse nuk janë trajtuar nga shteti me strehim dhe në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 49, dt. 29.01.1993 “Për përcaktimin e kriterëve për të pastrehët”, dhe janë në kushte të vështira jetese.

Jetimët të cilët pretendojnë për përfitimin e këtij statusi përgatisin dokumentacionin e mëposhtëm, të cilin e dorëzojnë pranë Zyrave Rajonale të Përkujdesit Shoqëror dhe konkretisht:

- a. Çertifikatën e lindjes së personit
- b. Dokumentacionin që vërteton trajtimin e tyre nga institucionet publike a private të përkujdesit shoqëror (shtëpitë e foshnjës dhe fëmijës ) nëse janë sistemuar në këto institucione.
- c. Çertifikatën e vdekjes së të dy prindërve, nëse asnjëri prej tyre nuk është gjallë.
- d. Vendimin e gjykatës së formës së prerë për rastin e heqjes së të drejtës prindërore të të dy prindërve ose të njërit prind, kur prindi tjetër nuk jeton.
- e. Vendimin e gjykatës që deklaron të braktisur fëmijën nga të dy prindërit, ose nga njëri prind dhe prindi tjetër nuk jeton.
- f. Për rastet e përcaktuara në pikat “d” dhe “e” dorëzohet dhe certifikata e vdekjes së prindit.



Personat që kanë kaluar moshën 25 vjeç përveç dokumenteve të mësipërme duhet të paraqesin si më poshtë vijon:


- Të jenë përfitues të ndihmës ekonomike
- Janë të pastrehë në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 49, datë 29.01.1993 “Për përcaktimin e kriterëve për të pastrehët”.

**Gjithsej përfitues nga ky ligj, deri ne vitin 2010, janë 1072 persona: nga këta 532 meshkuj dhe 540 femra. Të dhënat tregojnë që:**

- 95 veta janë përfituesit e Statusit të Jetimit për vitin 2009.
- 79 veta janë përfitues të Statusit të Jetimit për periudhën janar - nëntor 2010.
- 898 veta janë përfituesit e mbetur deri në vitin 2008.

**Përfituesit e Statusit të Jetimit të ndarë sipas Prefekturave (dmth ndarje edhe sipas Qarqeve):**

Prefektura	Tiranë	Shkodër	Vlorë	Dibër	Korçë	Fier	Lezhë	Gjirokastrë	Durrës	Berat	Kukës	Elbasan	Totali
Nr. Përfituesve	290	84	59	79	83	81	78	48	53	73	47	97	1072



#### **Përfitimet nga Ligji i Statusit të Jetimit**

- ✓ Vendosja në Institucione Publike dhe private të përkujdesit social
- ✓ Proritë në punësim dhe strehim
- ✓ Të drejta studimi sipas prirjeve dhe aftësive, bursë të plotë, trajtime me veshmbathje për vitet e shkollës.
- ✓ Jetimi që mbaron shkollën dhe nuk është sistemuar akoma në punë i jepet ndihmë ekonomike
- ✓ Jetimët që vazhdojnë shkollat për periudhën e verës (pushimet) trajtohen me pagesë suplementare (e përcaktuar me VKM)



- ✓ Jetimët përfitojnë shërbim shëndetësor, dentar dhe medikamente mjekësore falas nga shteti.
- ✓ Jetimët udhëtojnë falas me mjete transporti shtetëror dhe private kur nuk janë në marrëdhënie pune.
- ✓ Jetimët e vendosur në institucionet e përkujdesit social: hyrja në të gjitha spektaklet, veprimtaritë sportive etj bëhet me 50% të vlerës së biletës.
- ✓ Punësimi i jetimëve bëhet me përparësi nga Zyrat e Punës dhe Përkujdesit Social.
- ✓ Jetimët e punësuar trajtohen me përparësi nga punëdhënësi, duke krijuar mundësi për mbajtjen në punë gjatë procesit të shkurtimit të veprimtarisë.
- ✓ Jetimët trajtohen me përparësi në emigracionin e organizuar nga shteti dhe përjashtohen nga taksat në këto raste.
- ✓ Jetimët që kryejnë shërbimin e detyruar ushtarak, u jepet nga shteti një kuotë suplementare që caktohet me VKM. Djemtë jetimë që mbarojnë shërbimin ushtarak sistemohen me strehim e punë nga Bashkitë e Komunitat në bazë të kërkesës së bërë 6 muaj më parë nga Kryesia e Shoqatës. Në rast të kundërt sistemohen në konvikte. Shpenzimet e ushqimit përballohen nga zyrat e ndihmës dhe përkujdesit shoqëror deri në zënien e tyre në punë.
- ✓ Strehimi i personave që përfitojnë nga ky status bëhet me përparësi dhe me kredi afatgjata nga shteti, sipas kriterëve të përcaktuar në ligjin **8030, dt. 15.11.1995** "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha", si dhe aktet nënligjore përkatëse. Këshilli i Ministrave nxjerr aktet nënligjore përkatëse.

***Në lidhje me zbatimin e Ligjit të Statusit të Jetimit Shoqata Kombëtare e Jetimeve të Shqipërisë ka kërkuar dhe vazhdon të kërkojë ndryshimin e Ligjit Nr. 8153, date 31.10.1996 mbi "Statusin e Jetimit". Ndryshimi i disa neneve të këtij ligji është i domosdoshëm për të ndihmuar jetimët që përfitojnë këtë status.***

Konkretisht:

- **Neni Nr. 9** i këtij ligji shprehet: Shërbimi shëndetësor, shërbimi dentar dhe medikamentet për jetimët të cilët nuk janë në marrëdhënie pune sigurohen falas nga shteti. Për këtë Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit nxjerr aktet nënligjore përkatëse.

Aktet nënligjore kanë dalë por nuk gjejnë zbatim për arsye se vetë Ministria e Shëndetësisë nuk ka nxjerrë urdhëresa që të gjejë zbatim ky nen.

*Do të ishte e nevojshme që të nxirrej një urdhër i posacëm për spitalet dhe ambulancat shtetërore dhe private të vizitojnë dhe të shtrojnë për t'u mjekuar falas të gjithë jetimët që janë pajisur me status. Një ide e hedhur nga Shoqata e Jetimëve ka të bëjë me caktimin e dytre farmacive ku jetimët të marrin ilaçe falas. Duke pasur parasysh shpërndarjen gjeografike të jetimëve, aspektet që kanë të bëjnë me ushtrimin e veprimtarisë së lirë të farmacive, ndoshta do ishte mirë që skema të përfshijë të gjitha farmacitë. Kjo do të rriste mundësitë e jetimëve për t'u trajtuar me efikasitet.*

- **Neni nr. 10** që shprehet: Udhëtimi me mjete transporti shtetëror e privat qytetas si dhe ndërqytetës i jetimëve që s'janë në marrëdhënie pune bëhet falas. Ministria e Industrisë Transportit dhe Tregtisë nxjerr për këtë aktet nënligjore përkatëse.



Aktet nënligjore kanë dalë por nuk gjejnë zbatim të mjetet e udhëtimit dhe kur jetimi paraqet statusin nuk pranohet dhe përbuzet nga të gjithë.

*Do të ishte i nevojshëm forcimi i kontrollit të zbatimit të kërkesave të tilla ligjore nga ana e organeve shtetërore.*

- **Neni Nr. 12** punësimi i jetimit bëhet me përparësi nga Zyrat e Punës dhe kujdesit social. Ky nen rezulton të jetë i zbatuar në një nivel të kënaqshëm. Duket që ka një bashkëpunim të mirë mes Shoqatës së Jetimëve me SHKP.
- **Neni 17 Strehimi** i personave që përftojnë nga ky status bëhet me përparësi dhe me kredi afatgjatë nga shteti sipas kriterëve të përcaktuara nga ligjet e shtetit. Këshilli i Ministrave nxjerr aktet nënligjore përkatës.

Ky nen nuk ka gjetur dhe nuk po gjen zbatim në vendin tonë. *Me qëllim që të ashtuquajturat 'getot' e jetimëve të mos vijojnë në vend, duhen marrë masa të menjëhershme me programe të posaçme që mundësojnë ofrimin e strehimit për jetimët.*

Gjithashtu një propozim tjetër i Shoqatës Kombëtare të Jetimeve të Shqipërisë ka të bëjë me qindra fëmijë jetimë pa të dy prindërit. Kërkohet që të gjithë këta fëmijë që nuk kanë të dy prindërit dhe kanë fituar statusin e jetimit dhe mbahet nga një kujdestar, këta fëmijë duhet të subvencionohen nga shteti në mënyrë që të afërmit t'i mbajnë pranë tyre dhe të mos i dërgojnë në institucione.

***Në të gjithë vendin, ka 280 jetimë,<sup>65</sup> të cilët kanë nevojë për strehim.*** Këta jetimë janë kontigjent nga jetimoret e Shqipërisë dhe që sot jetojnë nëpër konviktet e shkollave të mesme në të gjithë vendin. Pjesa më e madhe e këtyre jetimëve, sipas Shoqatës së Jetimëve jeton në Tiranë (120 jetimë) në katër konviktet e shkollave të mesme (teknologjikja, ndërtimi, elektriku, rezervat), që janë bërë problem dhe për nxënësit që janë konviktorë në këto shkolla. Gjithashtu dhe në qytetet e tjera si në Shkodër, Durrës, Vlorë, Korçë, Elbasan, Gjirokastër ku kanë konvikte të shkollave të mesme janë të sistemuar dhe jetimë.

***Jetimët që kanë nevojë për strehim janë të shpërndarë në këto prefektura.***

Prefektura	Numri i jetimeve
Tiranë	120
Shkodër	66
Korçë	15
Vlorë	15
Gjirokastër	12
<b>Total</b>	<b>228</b>

**52 jetimët e mbetur janë të shpërndarë në rrethet Durrës, Lezhë, Elbasan, Kavajë.**

<sup>6</sup> Shoqata Kombëtare e Jetimëve të Shqipërisë




*Sipas Shoqatës Kombëtare të Jetimëve të Shqipërisë kanë përfituar strehim, jetimët të ndarë sipas Prefekturave si më poshtë:*

Prefektura	Numri i Jetimëve
Tirana	14 jetim
Berati	16
Durrësi	1
Fieri	2
Vlora	2
Shkodra	1
Lezha	1
Elbasan ( Librazhd )	1
<b>Totali</b>	<b>38 jetimë</b>

*Jetimët që marrin ndihmë ekonomike të ndarë sipas prefekturave:<sup>6</sup>*

Prefektura	Jetimët që marrin ndihmë ekonomike
Elbasan	25
Lezhë	36
Vlorë	1
Dibër	20
Berat	15
Tiranë	100
Shkodër	28
Fier	17
Gjirokastra	17
Kukës	12
Durrës	8
Korçë	44
<b>Totali</b>	<b>323</b>



Bazuar në VKM nr. 787, dt. 14.12.2005 "Për përcaktimin e kritereve të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike" përfitojnë ndër kategoritë e tjera dhe:

<sup>6</sup> SHSSH



- jetimët e papunë mbi 25 vjeç
- Jetimët e moshës 18-25 vjeç të cilët nuk janë të vendosur në institucionet e shërbimeve shoqërore ose nën kujdestari.

Masa e ndihmës ekonomike për çdo jetim të përcaktuar në shkronjat “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij vendimi është baraz me atë të një kryefamiljari e barabartë me 3000 lekë.

**Punësimi i jetimëve** – lë mjaft për të dëshiruar. Në këtë pikë Shërbimi Kombëtar i Punësimit i jep përparësi jetimëve në punësimin e tyre në thirrjet për vende të lira pune. Siç, shihet nga të dhënat vetëm 38 jetimë janë punësuar nga viti 2000-2004. Nga bisedat me jetimët që jetojnë te Qendra Formimit Profesional nr. 4 dhe me përfaqësuesin e Shoqatës Kombëtare të fëmijëve jetimë rezulton se edhe vendet e lira të punës dhe profesionet që shpallen nuk janë në përputhje me kërkesat e tyre. Ata më shume preferojnë që të punësohen në punë informale, pasi paga e tyre është pak më e lartë edhe pse është e kufizuar në kohë dhe jo e përhershme. Megjithatë punësimi i të rinjve le për të dëshiruar në këtë drejtim edhe si fakt i përgatitjes së ulët të të rinjve gjatë kohës në kujdes por edhe si rezultat i daljes së tyre në moshë të hershme nga kujdesi.

Disa nga jetimet të cilët kanë dalë nga format e përkujdesit shoqëror aktualisht janë të strehuar pranë Qendrës Formimit Profesional nr. 4.

Jetimët që jetojnë në këtë qendër, janë kategoria e jetimëve të cilët janë rritur dhe kanë jetuar në institucionet e përkujdesit shoqëror, por duke qenë se për arsye të ndryshme kanë arritur deri në moshë madhore në institucione (peng i prindërve, ose gjyshërve, të cilët nuk kanë dhënë konsensus për birësim) kanë mbetur pa asnjë formë tjetër përkujdesi. Këto ambiente sot, janë të okupuara prej tyre dhe aktualisht shpenzimet e dritave dhe të ujit paguhën nga buxheti i shtetit. Nga bisedat me ta rezulton se ata janë mësuar gjatë gjithë jetës së tyre që përkujdesja e shtetit (e mirë apo e keqe) t’i ndjekë në vazhdimësi, deri sa kanë arritur moshën madhore, për këtë arsye dhe ndjehen të paaftësuar me profesionet që kërkohen në tregun e punës, por edhe për arsyen tjetër se atyre nuk i pëlqen shumë të punojnë. Në këtë pikë del në pah edhe një mangësi e theksuar e strukturave të edukimit në IPSH, e cila është mospërçimi i vlerave të pavarësisë individuale dhe aftësisimit të tyre për të përballuar jetesën jashtë institucioneve.

Normalisht, duhet që këta jetimë pasi kanë dalë nga institucionet e përkujdesjes shoqërore duhet të jenë të aftë të përballen me tregun e punës dhe të kenë marrë një profesion të caktuar, si në shkollat e mesme me profesione të ndryshme, ku preferohen dega hotelieri, turizëm, ekonomik, profesione si teknik, hidraulik etj., po ashtu edhe të insistohet që të marrin një profesion në Qendrat e Formimit Profesional.

MPÇSSHB menaxhon programet e formimit profesional dhe të nxitjes së punësimit. Të dyja këto programe drejtohen nga Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe zbatohen nga agjencia zbatuese që është Shërbimi Kombëtar i Punësimit. Normalisht, këto programe duhet të jenë të harmonizuar me programin e politikave të shërbimeve sociale, por në praktikë rezulton se jetimët nuk kanë dijeni për këto programe, ata kanë përfituar në numër të pakët vetëm nga programet e formimit profesional, rreth 5 % e numrit total të tyre.





## V. Pjesa e katërt – Detyrimet e organeve qendrore dhe mangësitë.

---

### Detyrimet e çdo ministrie për statusin e jetimit

---

Ligjit Nr. 8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit” është një ligj i cili adreson një sërë institucionesh. Ai përcakton detyrime për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Ministrinë e Punëve Publike, Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Mbrojtjes. Në bazë të tij, jetimët me status jetimi trajtohen si grup prioritar për të përfituar nga programet që ka çdo Ministri.

### Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

---

Nenet 2, 3, 10, 19, 2

**Neni 2:** Personat që plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 1, përfitojnë nga ky status edhe pasi kanë kaluar moshën 25 vjeç, nëse nuk janë trajtuar nga shteti me strehim dhe janë në kushte të vështira jetese. Kriteret për trajtimin e tyre dhe afatet kohore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

**Neni 3:** Vendosja e fëmijëve jetimë në institucionet shtetërore ose private të përkujdesit shoqëror bëhet sipas kriterëve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

SHSSH dhe MPÇSShB zbatojnë kërkesat e nenit 4 dhe 5 mbi arsimimin dhe regjistrimin e tyre në Zyrat e Punës, ashtu edhe kërkesat e neneve 13, 14 që lidhen me trajtimin me përparësi të tyre për punësimin dhe emigracionin.

#### Për këtë janë hartuar dhe miratuar:

- Ligji 9355, dt. 10.03.2005 “Për Ndhimën dhe Shërbimet Shoqërore” i ndryshuar
- Ligji 10347, dt. 4.11.2010 “Për Mbrojtjen e fëmijëve”
- Ligji për arsimin dhe Formimin Profesional
  - Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”, i ndryshuar
  - Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 209, datë 14.4.2006 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, Publike dhe private, të përkujdesit shoqëror”
    - Udhëzim Nr. 2470, datë 06.12.2006 “Mbi zbatimin VKM nr. 209, datë 12.04.2006, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin në institucionet rezidenciale, publike dhe private të përkujdesit shoqëror”
  - Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 114, datë 31.01.2007 “Për përcaktimin e masës së kontributeve të personave që vendosen në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror”.
  - Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 233, datë 10.04.1998, “Për zbatimin e ligjit “Për statusin e jetimit””.
    - Udhëzimi nr. 20, datë 16.12.1998 “Për zbatimin e VKM nr. 233, datë 10.04.1998, “Për zbatimin e ligjit “Për statusin e jetimit” i APNSSH, si dhe
    - Udhëzimi për Dokumentacionin e nevojshëm për pranimet në Institucionet e përkujdesit shoqëror për fëmijët me probleme sociale.



## ***Detyrimet e Ministrive të tjera***

Ligji 8153/1996, i ndryshuar parashikon një sërë detyrimesh për ministritë e tjera si më poshtë:

### ***Ministria e Mbrojtjes***

Për ata jetimë që shkojnë për të kryer shërbimin ushtarak jep një kuotë prej 1000 lekë në muaj mbasi ata të pajisen me librezën e jetimit nga komisioni shtetëror pranë SHSSH.

### ***Ministria e Arsimit dhe Shkencës***

Neni 6, 8

**Neni 6:** Nxjerrja e një VKM për trajtimin me bursa dhe veshmbathje të jetimëve që vazhdojnë shkollat e mesme dhe të larta;

**Neni 8:** Jetimët që vazhdojnë shkollat e mesme dhe të larta, për periudhën e pushimeve verore, trajtohen me një pagesë suplementare që përcaktohet nga Këshilli i Ministrave.

### ***Ministria e Punëve Publike***

Neni 17: Strehimi i personave që përfitojnë nga ky status bëhet më përparësi dhe me kredi afatgjata nga shteti, sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha, si dhe aktet nënligjore përkatëse.

- Ligji nr. 9232, dt. 13.05.2004, «Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane»

*Tashmë është duke u hartuar një Projekt Strategji Sektoriale e Strehimit 2010-2020. Në diskutimet gjatë hartimit të kësaj projekt-strategjie janë dhënë sugjerime për përfitimin e strehimit për individët me statusin e jetimit edhe pas daljes nga institucionet e përkujdesit shoqëror e deri në një moshë të caktuar. Këto propozime lidhen edhe me Projekt Ligjin Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, i ndryshuar. Sugjerime të tilla janë shumë pozitive dhe adresojnë një problem të madh me të cilin përballet kategoria e jetimëve në vend.*

### ***Ministria e Shëndetësisë***

**Neni 9:** Shërbimi shëndetësor, shërbimi dentar dhe medikamentet për jetimët, të cilët nuk janë në marrëdhënie pune, sigurohen falas nga shteti me Vendim të Këshillit të Ministrave.

### ***Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve***

**Neni 11:** Për jetimët e vendosur në institucionet e përkujdesit shoqëror sigurohet hyrja në shfaqje, spektakle, veprimtari sportive etj. me 50 % të vlerës së biletës.

### ***Ministria e Transportit:***

**Neni 10:** Udhëtimi me mjetet e transportit shtetëror e privat qytetas, si dhe ndërqytetës i jetimëve që s’janë në marrëdhënie pune bëhet falas. Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë nxjerr për këtë aktet nënligjore përkatëse.



***Të gjitha detyrimet e mësipërme, siç shihet janë të parashikuara në Ligjin 8153/1996, i ndryshuar por informacione të detajuara nga çdo ministri nuk ka.***

***MPÇSSHB duhet të jetë lider në marrjen e këtij informacioni dhe të raportojë për të gjitha masat. Këto masa mbeten të fragmentarizuara dhe më lehtësisht për të pasur një situatë si kjo e tanishmja ku çdo ministri të pretendojë se ka zbatuar detyrimet sporadike për individët jetimë. Nga bisedat Shoqatën Kombëtare të Jetimeve rezulton se këta jetimë nuk kanë ndonjë përparësi, siç shprehet Statusi Jetimit, për zbatimin e detyrimeve. Jetimët nuk përfitojnë nga të gjitha lehtësirat që i ofrohen nga ky status.***

***Jo vetëm që institucionet përkatëse duhet të marrin 'pronësinë' e përgjegjësive të veta, por një sugjerim do ishte që MPÇSSHB, të ushtrojë më shumë presion ndaj institucioneve homologe në përmbushjen e detyrimeve nga ana e tyre.***



## VI. Pjesa e pestë – Sistemi legjislativ për fëmijët jetimë

---

Kuadri ligjor në fuqi që adreson çështjet e fëmijëve fillon që nga Kushtetuta, përfshin një sërë Konventash Ndërkombëtare të Ratifikuara si dhe ligjesh. JO vetëm akte ligjore (e nënligjore) janë të miratuara por edhe një sërë dokumentesh politike të cilat janë tregues të qasjes që qeveria shqiptare i bën çështjes së fëmijëve e posaçërisht të atyre jetimë. Një lisitim i këtyre dokumenteve dhe përmendje shkurtimisht e rregullimit përkatës bëhet në vijim.

### Kushtetuta

---

#### Neni 15

- Te drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë ne themel të te gjithë rendit juridik.
- Organet e pushtetit publik, ne përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

#### Neni 54

- Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti.
- Fëmijët e lindur jashtë martesë kanë të drejta të barabarta me të lindurit nga martesë.
- Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal.

### *Konventat Ndërkombëtare të ratifikuara*

---

- Konventa për të Drejtat e Fëmijës, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara me 20 nëntor 1989, ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në Shkurt 1992, që hyri në fuqi në Mars 1992.
- Konventa të tjera:
  - Konventa Europiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore.
  - Konventa ILO 182 “Për format me të këqija të punës së fëmijëve” dhe rekomandimi nr. 190, “Format me të këqija të punës së fëmijëve”.
  - Konventa e Hagës “Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit.
  - Konventën për Ndalimin me Forcë të Trafikut të Personave dhe shfrytëzimit të Prostitucionit të të Tjerëve (protokollin e Palermos).
  - Konventa Evropiane “Mbi marrëdhëniet me fëmijët”.
  - Konventa e Hagës “Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve mbi detyrimin ushqimor”.
  - Konventa nr. 182 e ILO-s për “Punën e rëndë të fëmijëve”.
  - Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut.



## Sistemi Legjislativ - **LIGJET**

---

- Kodi i Familjes
- Kodi i Punës
- Kodi Civil:

Këto Kode parashikojnë:

- të drejtat juridike dhe të drejta për të vepruar
- të drejta pasurore dhe trashëgimtare
- Detyrimet e prindërve për të siguruar mirëqënie dhe edukim
- Birësimi – Interesi më i lartë i fëmijës dhe garantimi i respektimit të drejtave të tij themelore.

- Kodi Penal – parashikon rastet kur:

- Të miturit nën 18 vjeç të dënuar me burgim nuk mund të marrin më shumë se gjysma e dënimit të parashikuar për të rriturit.
- Fëmija ka përgjegjësi penale me mbushjen e moshës 14 vjeç për veprat penale dhe 16 vjeç për kundërvajtjet penale.
- Trafikimi i fëmijëve
- Parashikohet Braktisja e Fëmijës
- Vrasja e foshnjës
- Shfrytëzimi për qëllime përfitimi
- Dhunimi seksual

- Kodi i Punës parashikon

- Për punëmarrësit nën moshën 18 vjeç ndalohet puna e natës dhe pranimi në punë bëhet vetëm pas një kontrolli mjekësor të plotë, i cili i njeh si të aftë për punë, shpenzimet e të cilit përballohen nga punëmarrësi.
- Mosha minimale e pranimi në punë është 16 vjeç.
- Punësimi në moshën 14 vjeç bëhet në punë të lehta që nuk dëmtojnë shëndetin

- Ligje të tjera:

- Ligji për ndihmën dhe shërbimet shoqërore;
- Ligji për arsimin e detyruar;
- Ligji për shëndetin publik
- Ligji për Statusin e Jetimit
- Ligji për birësimet
- Ligji për kujdestarinë

**Ligji Nr. 9355 datë 10.03.2005 “Për Ndihmën Ekonomike dhe Shërbimet Shoqërore”** (ndryshuar fjalë dhe shtuar pika me ligjin nr. 10399, datë 17.3.2011) hedh bazat e modernizimit të sistemit të mbrojtjes sociale. Ligji përcakton:

- Strukturën dhe tipologjinë e shërbimeve të përkujdesit shoqëror;
- Mënyrën e organizimit, funksionimit dhe financimit të tyre;
- Kategoritë e përfituesve nga shërbimet institucionale dhe komunitare;
- Kriteret e përfitimit të shërbimeve institucionale



- Mënyrat e monitorimit dhe vlerësimit të shërbimeve të ofruara nga operatorët publikë dhe jopublikë.

VKM 563 “Për përgjegjësitë dhe kompetencat e qarkut” - i cili është përcaktuar si aktori kryesor në kuptimin e përgjegjësisë për administrimin e politikave sociale rajonale

**“Për Përcaktimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në Institucionet Rezidenciale, Publike dhe Private, të Përkujdesit Shoqëror”,** baza ligjore nuk i referohet më VKM nr. 209 datë 12.04.2006 pasi ka ndryshuar dhe është futur në zbatim **VKM nr. 425 date 27.06.2012**, ajo është e bazuar mbi VKM e mëparshme por ka disa shtesa apo ndryshime të vogla por të rëndësishme në përmbajtje si:

- Është rritur moshën e qëndrimit të fëmijëve në institucionet e përkujdesjes shoqërore **nga 15 vjeç sipas VKM së mëparshme në 16 sipas VKM së re.**
- Tek kriteret e vendosjes është shtuar gërma g në pikën 1.1 e cila parashikon vendosjen e përkohshme të fëmijëve në institucionet e përkujdesjes (sipas termave të përdorura në VKM), praktike që nuk ka qenë e parashikuar në VKM e mëparshme.
- Gjithashtu është shtuar procedura për vendosjen në institucionet e përkujdesjes shoqërore të viktimave të trafikimit dhe viktimave të mundshme të trafikimit.
- Nuk ka ndryshime në përmbajtjen e dokumentacionit që duhet përmbushur për rastin.
- Po kështu pika 3 e kreut VI të VKM-së së re parashikon të njëjtën procedurë si në VKM e mëparshme që “fëmijët që sistemohen në institucionet rezidenciale, të cilët u përkasin familjeve me probleme sociale, pas një periudhe 5-vjeçare të qëndrimit të tyre në këto institucione, bëhet rivlerësim i gjendjes shoqërore dhe ekonomike të familjeve të tyre nga administratorët e njësive vendore. Gjendja e re shoqërore dhe ekonomike i njoftohet këshillit të njësive të qeverisjes vendore i cili rishikon vendimin për qëndrimin e mëtejshëm ose jo të fëmijëve në institucion”.

#### **Ligji për arsimin parauniversitar:**

- në përputhje me Kushtetutën (N. 57) është sanksionuar parimi se kushdo ka të drejtën për arsimim.
- arsimi i detyruar në Shqipëri është ai 9-vjeçar.

#### **Strategjitë e miratuara**

---

- Strategjia për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve – Plani i saj i veprimit
- Strategjia e Përfshirjes Sociale
- Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2007-2013
- Strategjia e Kujdestarisë së Përkohshme
- Strategjia e trafikimit të qënieve njerëzore në përgjithësi dhe atë të fëmijëve në veçanti.
- Standardet e shërbimeve shoqërore dhe veçanërisht ato të fëmijëve
- Plani i Veprimit për Strategjinë e Fëmijëve, 2012 -2015

#### **Strategjia për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve**

- Sigurimi i mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët, pavarësisht nga moshën, gjinia, etnia, aftësia e kufizuar, statusi i lindjes etj.



- Ngritja e strukturave dhe sigurimi i burimeve të mjaftueshme financiare e njerëzore, për të realizuar detyrimet që rrjedhin sidomos nga Konventa për të Drejtat e Fëmijëve.

### **Strategjia Kombëtare për Fëmijët.**

- Vazhdimësia e procesit që siguron respektimin e interesave të fëmijëve, të drejtën e informimit dhe të lirisë së shprehjes dhe pjesëmarrjen e tyre në të gjitha çështjet që lidhen me ta në familje, në shkollë dhe në institucione të tjera.
- Ngritja e sistemit të institucioneve dhe marrja e masave të tjera të domosdoshme, për të mbrojtur fëmijët nga të gjithë format e dhunës, të shfrytëzimit dhe nga keqtrajtimet.
- Sigurimi i jetesës së fëmijëve në mjedis familjar, dhe vetëm në pamundësi të kësaj, ofrimi i kujdesit alternativ, ku përparësi të ketë kujdestaria në familjet sociale.
- Përsosja e kuadrit ligjor në fushën e birësimeve, duke synuar birësim të sigurt dhe të përshtatshëm për fëmijët.

### **Strategjia për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve**

- Ulja e numrit të fëmijëve të rrugës dhe ngritja e shërbimeve që i mbrojnë dhe zhvillojnë ata.
- Reduktimi i numrit të fëmijëve që punojnë dhe garantimi i sistemit të mbrojtjes së tyre.
- Ndërtimi i sistemit arsimor bashkëkohor, duke garantuar që të gjithë fëmijët të mësojnë në kushte të përshtatshme dhe të përfundojnë arsimin e detyruar.
- Rritje e kujdesit për t'u krijuar shanse të barabarta fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- Përmirësimi i kujdesit dhe shërbimit shëndetësor për nënën dhe fëmijën, me synim arritjen e standardeve normale në këtë shërbim.

### **Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2007-2013**

- Asistence për familjet në varfëri. Zbutje të varfërisë.
- Shtrirja e kushtëzimit të përfitimit të ndihmës ekonomike nëpërmjet punës, në të gjithë vendin.
- Përmirësimi i targetimit për skemën e ndihmës ekonomike.
- Përmirësimi i administrimit të subvencionit për energjinë.
- Hartimi dhe miratimi i standardeve të perkujdesit për fëmijë;

### **Standardet**

- Standarde të përgjithshme;
- Standarde për fëmijët që trajtohen me shërbim rezidencial;
- Standarde për shërbimet e fëmijëve me Aftësi të Kufizuar
- Standarde për viktimat e Trafikimit;
- Risi në këto standarde: Ankimimi-Instrument për të dëgjuar zërin e përfituesve;
- Pjesëmarrja e përfituesve në vendimmarrje;

### **Strategjia e kujdestarisë**

*Parimet:*



- Të gjithë fëmijët duhet të gëzojnë të drejtën e rritjes me dashuri në një mjedis familjar të qëndrueshëm;
- Të gjithë fëmijët duhet të gëzojnë të drejtën e mbrojtjes nga abuzimi fizik, psikologjik apo seksual;
- Të gjithë fëmijët duhet të gëzojnë të drejtën e ofrimit të alternativave të ndryshme të kujdesit me bazë familjen në rastet e mungesës së asaj biologjike;

*Synohet:*

- Kuadër ligjor i përmirësuar dhe i plotësuar për të mundësuar zbatimin e shërbimit të kujdestarisë për fëmijë;
- Sensibilizimi i shoqërisë lidhur me shërbimin e kujdestarisë për fëmijë dhe përparësitë e tij;
- Ngritje kapacitetesh profesionale të të gjithë aktorëve që do të përfshihen në ofrimin e shërbimit të kujdestarisë;
- Procedura dhe dokumentacion i gatshëm për të ofruar një shërbim cilësor të kujdestarisë për fëmijë;

**Strategjia e Trafikimit të qënieve njerëzore 2008-2010**

*Parimet*

- Trajtim i viktimave bazuar në të drejtat e njeriut;
- Qeveria - Përgjegjësia kryesore
- Pjesëmarrja më e gjerë e shoqërisë civile,
- Ofrim i mbrojtjes dhe asistencës për të gjithë viktimat që mendohen se janë të tillë dhe nëse ato nuk kanë dëshirë të dëshmojnë;
- Identifikimi i rasteve të mundshme dhe atyre aktuale të trafikimit të fëmijëve;
- Sigurimi i marrjes së masave parandaluese, mbrojtëse dhe rehabilituese;
- Ngritja e sistemeve të institucionalizuara efektive të mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor, që kanë për synim identifikimin e grupeve dhe individëve në rrezik, si edhe të miturit e trafikuar;
- Sigurimi i aksesit për arsimim dhe përgatitje aftësish për jetën.
- Evidentim i problemeve sociale negative
- Shfrytëzimi ekonomik dhe seksual
- Trafikimi i fëmijëve
- Dhunimi Fizik
- Rekrutimi i fëmijëve për trafikim e ka burimin të familjet me:
  - Kujdes familjar të brishtë dhe prindër të divorcuar.
  - Fëmijë të mbetur jetimë dhe pa kujdes.
  - Shumë fëmijë dhe në gjendje të vështirë ekonomike.
  - Prindër të punësuar jashtë vendit.
  - Fëmijë që kanë braktisur shkollën dhe janë marrë me lypësi
  - Fëmijë që merren me veprimtari të kundërligjshme në Shqipëri
- Ratifikimi i Protokollit të Palermos për Luftën kundër trafikimit të grave dhe fëmijëve, ka sjellë ndryshime në legjislacionin penal.
- Krimet e kryera kundër fëmijëve kanë një dënim më të madh.
- Është krijuar qendra e Riedukimit për të mitur me vepra penale dhe me çrregullime në sjellje.





### **Shfrytëzimi seksual**

Kodi Penal parashikon si vepër penale:

- rastet e marrëdhënieve seksuale, ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari.
- marrëdhëniet seksuale, homoseksuale, si dhe çdo akt tjetër seksual me fëmijë të mitur, që nuk ka arritur moshën 14 vjeç, ose me fëmijën e mitur që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, vepër për të cilën kur kryhet me dhunë, ose sjell si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e fëmijës së mitur, zbatohet një dënim më i rëndë se në rastin e parë.
- shfrytëzimin e fëmijëve për qëllime prostitucioni dhe dënohet më rëndë kur shtytja, ndërmjetësimi, ose marrja shpërblim për ushtrimin e prostitucionit kryhet ndaj një të mituri.

Në bazë të Kodit të Familjes, prindit i hiqet e drejta prindërore me vendim gjykate në rastet kur:

- Gjykata konstaton se prindi shpërdoron të drejtën prindërore apo tregon pakujdesi të rëndë në ushtrimin e saj,
- Kur me veprimet e tij ndikon në mënyrë të dëmshme në edukimin e fëmijës,
- Kodi penal parashikon dhe rastet e keqtrajtimit dhe abuzimit të fëmijëve, e cila shoqërohet dhe me masat përkatëse të dënimit;

***Siç shihet, nga pikëpamja ligjore kategoria e fëmijëve pa kujdes prindëror është mjaft e mbrojtur. Konventat e nënshkruara, Strategji të miratuara, Ligje dhe VKM dhe referime specifike në Kodet përkatëse kanë të mirëparashikuara masat dhe detyrimet që ndërmerren përsipër nga shteti. Duke konsiderur që kuadri ligjor në përgjithësi është i miratuar, mund të konkludohet që ajo që nuk funksionon mirë është zbatimi i masave dhe detyrimeve nga çdo aktor i parashikuar në legjislacion.***

### **Por nga pikëpamja ligjore, janë të nevojshme këto ndryshime**

- Zgjerimi i kategorisë mbështetëse, jo vetëm për “jetimët biologjikë” për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë “pa kujdes prindëror”. Duhet realizuar një rishikim i ligjit të statusit të jetimit, duke zgjeruar konceptin e ‘jetimëve socialë’ në nenin 1. Sic përmendet edhe më lart, vetëm 3% e fëmijë në kujdes janë jetimë biologjikë. Udhëzimet për Përkujdesjen Alternative njohin shtrirjen e shërbimeve për fëmijën deri në moshën 18 vjeç në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijës si dhe ofrimin e paketave pas-mbështetëse për çdo fëmijë.
- Rritja e moshës në kujdes ose ofrimi i paketave mbështetëse deri në moshën 18 vjeç që do të thotë me largimin e fëmijëve në konvikte, ndërmarrja e masave për mbështetjen e tyre me mentorimin, paketa ekonomike etj. Si pjesë e standarteve dhe aplikimit të tyre, hartimi i planeve konkrete për daljen nga kujdesi dhe shoqërimi i tyre me fatura financiare për mbështetje të riut deri në pavarësi të plotë
- Përmbushja e rekomandimeve: Duhet patur parasysh që në kuadër të Raportit Universal Periodik për raportimin e plotësimin të të drejtave të fëmijëve edhe të njeriut (1/4 vjet) shteti shqiptar ka marr përsipër rekomandimin për të realizuar zgjerimin e moshës në kujdes nga 15 në 18 vjeç (shiko: Literatura)



## VII. Pjesa e gjashtë – Të dhënat e studimit për përgatitjen e largimit nga kujdesi

---

Në analizën e mëposhtme janë përfshirë rezultatet e intervistave të **23 fëmijëve/të rinjëve** të vendosur në kujdes në institucionet rezidenciale publike, të moshës 13 - 18 vjeç që po përgatiten për të lënë kujdesin në institucionet Tiranë dhe Shkodër. Intervistat me fëmijët në kujdes janë realizuar nga 9 të rinj pa kujdes prindëror që janë trajnuar dhe kanë realizuar studimin “Kërkim mes Bashkmoshatarëve” si pjesë e projektit të bashkëfinancuar nga SOS Kinderdorf International dhe Komisioni European në Finlandë, Poloni, Ceki dhe Shqipëri. Të rinjtë në kujdes ndanë me intervistuesit historitë jetësore të tyre, opinionet, eksperiencat dhe situatën emocionale që ata përjetojnë në kujdes duke dhënë dhe rekomandimet e tyre për ndryshimin dhe përmirësimin e përgatitjes për daljen nga kujdesi. Më poshtë jepet një pasqyrë e saktë mbi situatën e të rinjve, anët e forta dhe të dobta në kujdes, mbështetjen që kanë nevojë etj. Çështjet mbi të cilat është mbledhur informacion për këtë target grup përfshijnë por nuk kufizohen, përgatitja për daljen nga kujdesi; akomodimi dhe strehimi; shëndeti fizik dhe emocional; raportet me shokët dhe familjen; dëshirat për të ardhmen etj.

**23 intervistat e zhvilluara me fëmijët/të rinjtë që po përgatiten të lënë kujdesin do të jenë bashkangjitur në pjesën e fundit tek rubrika SHTOJCA**

### I- TË DHËNA PERSONALE

#### **b. Moshë**

Të intervistuar: Grupmosha : 13-19 vjeç<sup>7</sup>

**c. Arsimi:** Kanë mbaruar arsimin 9 vjeçar ose janë duke e ndjekur atë

#### **Të dhëna për kujdesin alternativ**

##### **b. Nr. viteve që jeton në kujdes**

Shumica e fëmijëve kanë në kujdes nga 3 deri 10 vjet.

##### **c. Nr. Zhvendosjeve në kujdes**

1-3 zhvendosje por shumica raportojnë për dy zhvendosje gjatë kohës së qëndrimit në kujdes që lidhet gjithashtu edhe me ndryshimin e institucionit në varësi të moshës

##### **d. Fillimi i kujdesit (në moshën)**

13 përgjatë 0 - 6 vjeç dhe 10 të moshës 7 - 12 vjeç

Fëmijët e moshës më të vogël vendosen kryesisht në kujdes që do të thotë një rritje të braktisjes së fëmijëve në moshë të vogël

##### **e. Trajnime profesionale**

Vetëm 13 fëmijë kanë marrë trajnime dhe kurse profesionale kryesisht në zdrukthtari, hidraulik, gjuhë e huaj, kitarë, muzikë (5 fëmijë - 1 kurs; 2 fëmijë - 2 kurse; 4 fëmijë - 3 kurse; 1 fëmijë - 4 kurse)

---

<sup>7</sup> Në institucionin rezidencial në Shkodër është bërë pilotimi i kujdesit për të rinjtë deri në moshë madhore dhe qëndrimi i tyre deri në moshën 18 vjeç



## II- PËRGATITJA PËR DALJEN NGA KUJDESI

### 2.1 Personat Mbështetës për daljen

Nga të dhënat del se pjesa më e madhe e fëmijëve/të rinjve të intervistuar janë shprehur se, si personat mbështetës kryesor për daljen nga kujdesi shohin punonjësit e kujdesit (20 fëmijë) dhe më pak shohin familjen ose të afërm, vetëm 11 fëmijë. Gjithashtu nga grafiku i përgjigjeve del qartë se personat jashtë kujdesit (mësuesit dhe shokët) janë pjesë e rëndësishme për mbështetjen e fëmijëve (17 fëmijë). Nga përgjigjet e dhëna vendin kryesor e zënë punonjësit e kujdesit ndër ta një rol të rëndësishëm punonjësi social, më pas vijnë mësuesit dhe në fund listohen familjarët.

Përfundimi është i qartë që për pjesën më të madhe të tyre është e vështirë mbështetja nga familja për daljen nga kujdesi, pra shanset për shumë prej të rinjve për tu bashkuar me familjen biologjike e vështirë të realizohet.

#### Sugjerime:

Të krijohen mundësit dhe të ndërmerren aksione konkrete nga punonjësit e kujdesit për të forcuar lidhjen e fëmijëve/të rinjve me familjen dhe të afërmit. Hartimi i planeve individuale me strategji të qarta, veprime konkrete, takime për të forcuar lidhjen dhe rritur përgjegjësitë familjare. Punonjësit social në institucione të luajnë një rol kyç dhe të shërbejnë si një urë lidhëse, informuese, për realizimin me sukses dhe forcimin e lidhjes mes fëmijës dhe familjarëve.

Të inkurajohet, të mbështetet dhe të forcohet lidhja e fëmijëve me personat jashtë kujdesit që ata i shohin si të rëndësishëm konkretisht mësuesit dhe shokët, element që do ti ndihmojë të rinjtë për integrimin e plotë në shoqëri. Realizimi i takimeve dhe aktiviteteve të përbashkëta me këta persona. Përfshirja e tyre në hartimin e planit për daljen nga kujdesi dhe ofrimi i tyre duke i ftuar periodikisht në vizita në institucion.

Ndarja e informacionit dhe eksperiencave pozitive, takime të përbashkëta, vizita të ndërsjella me të rinjtë dhe stafin në ofruar jo publik të suksesshëm në kujdes alternativ konkretisht SOS Fshatrat e Fëmijëve, Hope for the World, Qendra Ravasco (Shkodër) etj.

### 2.2 Aftësitë për Jetën

Nisur nga përgjigjet e të rinjve, aftësitë më të dobëta për daljen nga kujdesi mbeten Aftësitë Jetësore (konkretisht Gatimi dhe të Bërit Pazar që zënë vendin e parë) pra del në pah se sa të vështirë do e kenë të rinjtë për të përmbushur nevojat bazë për mbijetesë pas daljes nga kujdesi, më shumë se 82 % e tyre kanë aftësi të dobta në këtë drejtim. Po të njëjtën vlerë merr dhe Shëndeti 82% (konkretisht informacioni mbi Marrëdhëniet Seksuale) duke qënë se të rinjtë e intervistuar janë në moshë adoleshente, seksualiteti është pjesë e rëndësishme e zhvillimit dhe mirëqënies së tyre, por ata kanë mangësi informacioni dhe aftësi të dobta përfaqse në këtë fushë, element që mund të bëhet shkak për probleme serioze shëndetsore ose pasoja negative jetësore në të ardhmen. Aftësitë Sociale (konkretisht në Marrëdhënie me Persona Zyrtar) del se ata ndihen të dobët dhe të pafuqishëm në krijimin e marrëdhënies sociale sidomos në marrëdhënie me persona zyrtar, afërsisht 47 % e tyre. Gjithashtu një numër i konsiderueshëm 34% i të rinjve janë shprehur për aftësi të dobta në Menaxhimin e parave kjo mund të bëhet një pengesë e madhe në momentin që ata dalin nga kujdesi dhe do kenë një shumë minimale për të mbyllur muajin. Duke u bashkuar bashkë këta dy faktor para të limituara dhe mos menaxhimi korrekt i tyre mund ti çojë të rinjtë drejt një situatë alarmante për mbijetesën e tyre.

#### Sugjerime:

Informim dhe përmirësimi i aftësive jetësore të të rinjve mbi Gatimin dhe të Bërit Pazar nga punonjësit e kujdesit. Kjo mund të realizohet duke i informuar në vazhdimsi mbi këto çështje, përfshirë në procesin e gatimit dhe bërjen e pazarit, duke i lënë përgjegjësi të caktuar të rinjve mbi praktikimin dhe zhvillimin e aftësive të lartëpërmendura.

Informim, këshillim dhe trajnimi i të rinjve për kujdesin mbi shëndetin, marrëdhëniet e shëndetshme, mosha e përshtatshme për fillimin e marrëdhënies seksuale, parandalimi i abuzimeve, ndikimi i lëndëve narkotike në shëndet, mirëqenia fizike, përdorimi i metodave



mbrojtëse etj. Ky sensibilizim mund të bëhet në disa forma individualisht nga punonjësi social ose psikologu në kujdes. Në të njëjtën kohë mund të bëhen trajnime më të specializuara dhe specifike me të rinjtë nga profesionistë të organizatave të ndryshme, punonjës të kujdesit shëndetsor etj.

Rritja e aftësive sociale të të rinjve përfshirja në aktivitete jashtë qendre, vizita në institucione të ndryshme publike dhe diskutimi me persona zyrtar. Përfshirja e të rinjve në aktivitete të përbashkëta ose rrjete sociale me bashkëmoshatarë të tyre brenda dhe jashtë vendit.

Informimi i të rinjve mbi buxhetin që ka nevojë një i ri, menaxhimin financiar dhe shpenzimet që bëhen konkretisht për ta. Aktivizim praktik duke i dhënë përgjegjësi dhe detyra konkrete në shpenzime ose menaxhim parash.

### **2.3 Informacioni që i mungon fëmijës për daljen nga kujdesi**

Duke qënë se të ardhurat e tyre në momentin që dalin nga kujdesi do të jenë minimale dhe me të cilën është e pamundur për të përballuar jetesën me këtë kuotë duhet patjetër që të rinjtë të kenë informacion mbi punësimin.

Shumica e të rinjve 91% e tyre shprehën se informacioni që mungon për daljen nga kujdesi është Punësimi. Në një treg shumë konkurrues dhe me mundësi të limituara punësimi për një pjesë të tyre do të jetë shumë e vështirë nëse ata nuk janë të mirë informuar ose para përgatitur. Gjithashtu për të siguruar mbijetesën, vazhduar shkollimin ata do e kenë të nevojshme të punësohen në një moshë të re qoftë me punë sezonale qoftë me kohë të plotë pas daljes nga kujdesi. Aktualisht ata kanë mangësi informacioni mbi aftësi të veçanta për profilet e punësimit dhe Agjensitë e Punësimit.

Shqetësimi i mësipërm shoqërohet po ashtu me një numër të lartë të rinjsh që kanë mungesë informacioni mbi mbështetjen financiare për daljen nga kujdesi. Të rinjtë që pas daljes nga kujdesi do të përfitojnë statusin e jetimit do të marrin një kuotë minimale nga 3000 deri 5000 lek në muaj, por një pjesë e konsiderueshme nuk e përfitojnë dot statusin kështu që automatikisht përjashtohen nga pagesa.

Po ashtu një numër i madh i të rinjve 86% e të intervistuar kanë ngritur shqetësimin e mungesës së informacionit mbi Shkollimin dhe trainimin e tyre pas daljes nga kujdesi. Normalisht për punësimin e kënaqshëm në të ardhmen, sigurimin me dinjitet të jetesës një rol themelor ka dhe edukimi ose formimi i ardhshëm që ata do të marrin.

Një vend të rëndësishëm në listën e informacionit që i mungon mbetet Strehimi, 82% e të rinjve. Gjithashtu shqetësim për të rinjtë është mungesa e informacionit mbi shëndetin 73% e tyre. Ndërsa 74% e tyre janë shprehur se i mungon informacioni mbi mirëqënien emocionale, që të rinjtë të përballojnë me sukses sfidat e të ardhmes dhe kalimin në pamvarësi të plotë ata mbi të gjitha duhet të gëzojnë mirëqënie dhe qëndrueshmëri emocionale por nga përgjigjet del se ata kanë pak informacion ose përgatitje në këtë fushë. 78% e të rinjve të intervistuar janë shprehur se u mungon informacioni mbi çështje që lidhen me financat (mbështetja financiare dhe menaxhimi buxhetit).

#### **Sugjerime:**

Informim mbi agjensitë publike dhe jo publike të punësimit, mbi tipin e mbështetjes që këto ofrojnë, procedurat për tu rregjistruar në këto zyra dhe përfituar nga shërbimet e tyre.

Seanca informuese individuale dhe në grup nga psikologu për të siguruar qëndrueshmëri dhe maturim emocionale tek të rinjtë. Rritja e vetë vlerësimit dhe vetëbesimit tek të rinjtë.

Vlerësim i aftësive dhe informim nga punonjësi social, stafi në kujdes mbi shkollimin e përshtatshëm pas daljes nga kujdesi. Ofrimi i disa alternativave të edukimit pse jo dhe orientimi drejt një edukimi cilësor. Për nxënës të mirë negociimi me institucione arsimore brenda dhe jashtë vendit për sigurimin e bursave.

Seanca sensibilizuese, informuese mbi pasojat dhe efektet në shëndet nga përdorimi i lëndëve narkotike dhe alkooli. Këto të realizohen nga profesionist të specializuar në fushat e lart përmendura.

Trajnime specifike mbi menaxhimin financiar nga persona të specializuar jashtë kujdesit, marrja e roleve praktike dhe rritja e përgjegjësive me mbështetjen e punonjësve të kujdesit.



## 2.4 Ndhimja që nevojitet

Të rinjtë në pyetjen se çfarë ndihme u nevojitet për daljen nga kujdesi kanë listuar një numër të gjatë përgjigjesh. Në listën e përgjigjeve vendin e parë e zë mbështetja që ata duan për Strehimin 35% e tyre duke theksuar dhe një herë se sa i rëndësishëm është strehimi dhe sa shqetësues është për ta ky fakt pas daljes nga kujdesi. Më pas renditet Shkollimi me 30%, i cili tregon dy anët e një medalje: në rradhë të parë të rinjtë janë të ndërgjegjësuar për rëndësinë e shkollimit për të ardhmen dhe në anën tjetër ata kërkojnë ndihmë pikërisht për të përmbushur me sukses edukimin e tyre, element që do u sigurojë një punësim të kënaqshëm dhe integrimin në shoqëri. Dy përgjigje që lidhen shumë me njëra-tjetër dhe në këtë pyetje kanë të njëjtin numër 21% secila, janë ndihma për Punësim dhe ndihma Financiare pa të cilën ata nuk mund të sigurojnë dot mbijetesën e tyre.

### Sugjerime:

Nëse duam që të rinjtë të kalojnë me sukses daljen nga kujdesi dhe kalimin në pamvarësi të plotë duke u bërë qytetar dinjitoz të shoqërisë sonë, si fillim prioritet duhet të jetë mbulimi i nevojave bazë konkretisht për: Strehimin, Edukimin, Mbështetja Financiare e më pas Punësimi i tyre.

Kjo ndihmë për të rinjtë duhet të sigurohet nga përmirësimi i kuadrit ligjor dhe politikave të përshtatshme hartuar e miratuar nga institucionet politikbërëse duke u shoqëruar dhe me buxhete konkrete. Zbatimi dhe vënja në jetë i politikave të hartuara nga institucionet e kujdesit dhe monitorimi me rigorizotet nga institucionet inspektuese për garantimin e shërbimeve cilësore në kujdes.

Një rol themelor për sigurimin e shërbimeve cilësore do kenë iniciativat dhe përgjegjësitë që do të ndërmarrë stafi, që punon drejtpërdrejt me fëmijët në kujdes, në përmbushjen me sukses të standarteve për fëmijët në institucionet rezidenciale.

## 2.5 Anët pozitive të kujdesit

Normalisht të rinjtë kanë vlerësuar dhe anët pozitiv të kujdesit ku vendin e parë e zë treguesi Kujdesi ndaj tyre, stafi dhe kushtet që ata përfitojnë në institucione (interesante është fakti se megjithëse ky tregues zë vendin e parë në klasifikim vetëm 12 të rinj nga 23 kanë zgjedhur këtë përgjigje, pra 52 % e të intervistuarve). Anë tjetër pozitive e kujdesit është plotësimi i nevojave bazë për Ushqim & Veshje (7 të rinj kanë zgjedhur këtë përgjigje). 7 të rinj kanë zgjedhur Edukimin në kujdes si anë pozitive (pra afërsisht 30 % e të intervistuarve). Me pas me një numër të njëjtë vijne Trajnimi & kurset; Strehimi; Shëndeti & higjiena; Socializimi & argëtimi (secili prej treguesve të lartpërmendur është përzgjedhur nga 4 të rinj). Vendin e fundit në listë tek anët pozitive të kujdesit e zë Ndhimja Financiare vetëm me 2 fëmijë që shprehen për të. Njëri nga të rinjtë shprehet **“ndihmë në pak para”**, pra siç shihet ky variabël lë shumë për të dëshiruar dhe duhet të ndryshojë patjetër.

### Sugjerime:

Pamvarësisht se flitet për anët pozitive të kujdesit në dallim nga pyetjet e tjera këtu numri dhe përqindja e të rinjve që shprehen pro 1 alternative mbetet shumë i vogël, në rastin më të mirë vetëm 52%. Ndryshimi duhet të fillojë nga treguesit me numrin më të vogël të përzgjedhjes nga fëmijët si Ndhimja Financiare (patjetër duhet të rishikohet dhe rritet mbështetja financiare në para) dhe të pasohet deri tek treguesi i parë në renditje Kujdesi, stafi & kushtet në institucion.

## 2.6 Anët negative të kujdesit

Tek pyetja mbi anët negative të kujdesit të rinjtë kanë dhënë pak përgjigje. Element që tregon se të rinjtë duke pasur mungesën e jetesës me familjen e vlerësojnë realisht dhe objektivisht kujdesin e marrë në institucione. E veçanta e kësaj pyetje është se na sjell në vëmendje ose nxjerr në pah çështje që nuk kanë arritur të shfaqen nga përgjigjet e rubrikave ose pyetjeve të tjera. E veçantë, ajo që përbën shqetësim duke pasur numrin më të lartë të përzgjedhjes nga të rinjtë janë përgjigjet mbi Kufizimet në orare ose Mungesa e mundësive dhe lirisë, (pamvarësisht se mban vendin e parë ky variabël është përzgjedhur nga vetëm 6 të rinj). Një përgjigje mbresëlënëse dhe interesante vjen nga një i ri i cili shprehet **“duke qënë çdo gjë gati dembelosen fëmijët”**, kjo përgjigje shpreh pasivitetin e jetesës në institucion. Mirëqënia emocionale zë vendin e dytë duke u karakterizuar nga përgjigje si



Dhuna dhe Zënkat (5 fëmijë). Me një numër të njëjtë vijnë 2 variablat e tjerë konkretisht Jetesa Ndryshe/Jo si Familja (2 fëmijë) dhe Ushqimi (2 fëmijë)

**Sugjerime:**

Të sigurohet liri dhe fleksibilitet më i lartë i të rinjve në institucione, kjo të garantohet nga punonjësit e kujdesit. Jeta e tyre të bëhet më dinamike dhe aktive (në cilësi e sasi) duke u përfshirë në aktivitete brenda dhe jashtë institucionit. Të rinjtë të motivohen dhe aktivizohen në fusha të ndryshme të jetës sociale, jo vetëm kurse por dhe aktivitete kulturore, artistike, argëtuese etj.

### III - AKOMODIMI & STREHIMI

#### 3.1 Informacion për akomodimin pas largimit nga kujdesi (ku do të transferohet & a ka informacion)

Nga të dhënat e intervistave del qartë se sa Pak ose Aspak të informuar janë të rinjtë rreth akomodimit të tyre pas kujdesit, pothuajse 50% e tyre. Pjesa tjetër rreth 35% janë të informuar që do kalojnë nën kujdesin e NGO-së “Shpresë për Botën”. Dhe një përqindje e vogël ka informacion që do të rikthehet pranë familjeve (13% e të rinjve) ose janë të informuar për konviktet shtetërore (po 13%). Duke qënë se pjesa më e madhe e të rinjve nga kujdesi publik do të akomodohen tek “Shpresë për Botën” dhe jo në konvikt shtetëror, cilëson faktin e dallimit të madh mes akomodimit nga institucionet publike (konkretisht konvikt) dhe jo-publike. Duke qënë së për pjesën më të madhe do ofrohet kujdes nga Shpresë për Botën del në pah se kjo nuk është mosha e përshtatshme për daljen nga kujdesi dhe ky hendek për momentin për disa fëmijë mbulohet nga një NGO në fakt duhet të jetë roli i shtetit që të sigurojë akomodimin dhe kujdesin e përshtatshëm për të rinjtë deri në një moshë më të përshtatshme për daljen. Pozitive do ishte që të rinjtë të merrnin kujdes, integroheshin dhe akomodoheshin pranë familjeve të origjinës por nga të dhënat del se është e pamundur prandaj roli i institucioneve publike duhet të jetë determinant në ofrimin e kujdesit cilësor për këtë grupmoshë.

**Sugjerime:**

Punonjësit e kujdesit ti informojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe saktësisht të rinjt për daljen nga kujdesi, gjithashtu të përfshihen aktivisht në këtë proces vetë të rinjtë.

Punonjësi social i kujdesit duhet të ketë kontakte të vazhdueshme me familjen e origjinës/familjarë së të rinjve duke siguruar informacion dhe mbështetur integrimin e të rinjve në familje kur është e mundur dhe garantuar interesin më të lartë të të rinjve.

Punonjësi social në kujdes të bashkëpunojë me strukturat lokale dhe NMF në lokacion për të siguruar më shumë informacion dhe mbështetje për familjen sidomos kur akomodimi i të rinjve në institucion lidhet me situatën social-ekonomike të familjes.

Në rastin e akomodimit në “Shpresë për Botën” përveç informacionit të plotë të siguruar për fëmijën, që shkëputja të bëhet në mënyrë graduale dhe pa dëmtuar mirëqënien social-emocionale të bëhen vizita paraprake të të rinjve tek “Shpresë për Botën” dhe aktivitete të përbashkëta.

Në kuadër të deinstitutionalizimit dhe transformimit të institucioneve të kujdesit të pilotohen forma shpi familje brenda kujdesit vetëm më grupmoshën e të rinjve 16-18 vjeç.

Të bëhet përmirësimi i kuadrit ligjor dhe politikave ekzistuese duke eliminuar si praktik akomodimin e të rinjve 16 – 18 vjeç në konvikte.

### IV - SHËNDETI FIZIK & EMOCIONAL

#### 4.1 Shëndeti Fizik

1. Shumë i mirë (18 fëmijë)
2. Mjaftueshëm i mirë (5 fëmijë)



Përgjithësisht shëndeti fizik i shumicës së fëmijëve është i mirë dhe ky është një aspekt mjaft pozitiv duke qënë se së shpejti ato nuk do kenë më kujdesin e të rriturve dhe do duhet të kujdesen për veten e tyre në të ardhmen.

#### 4.2 Shëndeti mendor/qëndrueshmëria emocionale

1. Shume i mire (14 f)
2. Mjaftueshem i mire (8 f)
3. Pergjithesisht i dobet (1 f)

Sic shihet dhe nga përgjigjet e mësipërme qëndrueshmëria e shumicës së të rinjve është shumë e mirë por në të njëjtën kohë kemi një numër të konsiderueshëm 8 fëmijë që janë përgjigjur mjaftueshëm mirë.

##### Sugjerime:

Duke qënë së në kujdes ka psikolog duhet që të këtë ndjekje, këshillim dhe mbështetje të vazhdueshme për të rinjtë pasi pas daljes nga kujdesi ata do të përballen me sfida të mëdha.

Në rastin kur shëndeti mendor është i dobët të kërkohet ndihmë më e specializuar për trajtimin e rasteve nga institucione ose organizata të specializuar në probleme të shëndetit mendor.

#### 4.3 Ndjesia e sigurisë

Nga përgjigjet e dhëna të fëmijëve/të rinjve të anketuar del se rreth 80% e tyre janë shumë të pasigurtë për të ardhmen që i pret (18 të rinj). Pak prej tyre kanë një lloj sigurie për të ardhmen 21 % (5 të rinj) nga këta, vetëm 2 të rinj shprehin se ndjehen të sigurtë pasi do kenë mbështetjen e familjes. Ky tregues shpreh një shqetësim të madh pasi nëse ata nuk ndjehen të sigurtë si mund të dalin nga kujdesi në këtë moshë kur pasiguritë, dilemat zotërojnë mendimet dhe emocionet e tyre. Gjithashtu po ashtu si çdo fëmijë tjetër i kësaj grupmoshe ata janë në moshën më delikate, adoleshencë.

##### Sugjerime:

Që të rinjtë të ndjehen të sigurtë duhet të ketë një përjasje të re, largimi nga kujdesi minimalisht të jetë në një moshë më të madhe e më të pjekur (të ketë kaluar adoleshencën) dhe me një përgatitje më dinjitoze në të gjitha aspektet.

#### 4.4 Shqetësimet në jetë

1. Mungesa ose largësia e familjes (11 fëmijë)
2. Pasiguria për jetën të ardhmen (3 fëmijë)
3. Edukimi/Shkollimi (2 fëmijë)
4. Të tjera (1 fëmijë)

Nga përgjigjet e mësipërme del se shqetësimet më të mëdha në jetë që kanë të rinjtë e intervistuar janë mungesa e familjes ose largësia nga ajo, pasiguria që ndjejnë për të ardhmen e tyre dhe ajo që i pret. Më pak të preokupuar janë për edukimin e tyre dhe kjo është mëse e logjikshme pasi këtyre fëmijëve i mungon elementi bazë në jetë, familja dhe siguria që të jep ajo. Duke i nxjerr nga kujdesi në moshë të hershme sistemi i braktis, i flak përsëri të rinjtë duke i përplasur në realitetin e vështirë të konviktit, mungesës totale të kujdesit duke vënë në dilemë integrimin e tyre në jetë.

##### Sugjerime:

Krijimi i urave lidhëse dhe intensifikimi i kontakteve të të rinjve me familjarët e tyre, kjo të realizohet e lehtësohet nga punonjësit social të kujdesit.

Në momentin që për të rinjtë vjen koha e daljes nga kujdesi dhe një pjese e vogël do kenë fatin e mirë që të ribashkohen me familjen e origjinës, të sigurohet që të rinjtë e tjerë që nuk e kanë këtë mundësi të marrin një kujdes sa më afër atij familjar të paktën minimumi deri në 18 vjeç, kështu do minimizojmë shqetësimet, do rrisim besimin, vetëvlerësimin e tyre dhe ata do jënë më të aftësuar për kalimin në pamvarësi në të ardhmen.



## V- RAPORTI ME SHOKËT & FAMILJEN

### 5.1 Aktivitete fizike të praktikuara

Fëmijët e intervistuar janë të ingranuar në aktivitete të ndryshme sportive (15 të rinj në aktivitete sportive ku pjesa më e madhe 14 ndjekin futbollin). 9 të rinj janë të angazhuar në aktivitete artistike (kitarë 4 të rinj; muzikë 3 të rinj; kitar 2 të rinj). Gjithashtu nga përgjigjet ka dalë se 11 të rinj kalojnë kohën e lirë me lexim dhe gjuhë të huaj. Ndërsa 5 të rinj e kalojnë në TV dhe Internet. Fillimi i adoleshencës është e hapur dhe mjaft e prekshme nga tundime të jashtme e vese të ndryshme ndaj ingranimi i tyre në aktivitete sportive e artistike është mjaft pozitiv pasi i mban ato larg problemeve të moshës. Në të njëjtën kohë aktiviteti fizik siguron dhe një mirëqenie fizike.

#### Sugjerime:

Vetëm do ishte mirë që këto aktivitete sportive ose artistike të ushtrohen rregullisht dhe zhvillohen pse jo për tu dhënë dhe një perspektiv si sportistë dhe artistë të afirmuar në të ardhmen. Ndjekja dhe motivimi i të rinjve nga punonjësit e kujdesit për të zhvilluar talentet e tyre.

Te rinjtë të vizitohen institucione sportivo-kulturore dhe ndarja e eksperiencës personale e profesionale nga persona që kanë lënë gjurmë në sportin ose artin Shqiptar, këta persona mund të ftohen të jenë të pranishëm në kujdes. Këto modele pozitive do shërbejnë si nxitje, frymëzim, motivim dhe udhërrefyes për të rinjtë që duan të zhvillojnë talentet e tyre.

### 5.2 Listo mbështetjet më të forta

Nga intervistat del se 73 % e të rinjve shprehen se shohin si mbështjen më të fortë stafin e kujdesit rezidencial pranë institucioneve ku ato ndodhen aktualisht (17 të rinj). Në total 14 të rinj vlerësojnë si mbështetje të fortë Familjen/Të Afërmit konkretisht janë shprehur për këto alternativa: 9 të rinj - Familja biologjike; 8 të rinj - Vellezerit; 1 i ri - Motra; 7 të rinj - Të afërm familjarë. Po ashtu kanë marrë të njëjtin vlerësimi nga të rinjtë si mbështetje e fortë Personat e tjerë jashtë kujdesit, 14 të rinj janë shprehur për to. Tek Personat jashtë kujdesit të rinjtë kanë zgjedhur: Mësuesit - 7 të rinj; Personat Fetar - 7 të rinj; Shokët - 7 të rinj; Stafi nga organizata të tjera - 2 të rinj.

#### Sugjerime:

Punonjësit në kujdes të njohin mirë personat që garantojnë mbështetjet më të forta për të rinjtë jashtë kujdesit dhe të sigurojnë bashkëpunimin më të frytshëm ndërmjet aktorëve të lartpërmendur. Të sigurohet përfshirja aktive e këtyre aktorëve në hartimin dhe zbatimin e planeve të kujdesit për të rinjtë.

Përsëri del në pah se mbështetja më e fortë për të rinjtë janë personeli në kujdes dhe është mirë që ky kujdes të shtrihet në kohë, pasi pjesa më e madhe e të rinjve nuk mund të integrohen pranë familjes së origjinës pas daljes nga kujdesi.

### 5.3 Listo mbështetjet më të dobëta

Nga aspekti i mbështetjes së të rinjve për daljen nga kujdesi pjesa më e madhe e të rinjve, kanë klasifikuar si mbështetjen më të dobët personat jashtë kujdesit (22 të rinj - mësuesit, shokët, persona fetar etj). Nga të dhënat të habit fakti se 18 të rinj pra 78% e tyre kanë renditur Familjen dhe të Afërmit si mbështetje të dobët, ndërsa Stafin e kanë zgjedhur si mbështetje të dobët vetëm 7 fëmijë. Pra për të ardhmen shumica e të rinjve e ndjejnë që nuk mund të mbështeten tek familja dhe do ti duhet ta pëballojnë të vetëm daljen nga kujdesi.

#### Sugjerime:

Duke qënë se familja/të afërm shihen si mbështetja më e dobët automatikisht dhe integrimi në familje do jetë i pamundur për shumicën e të rinjve, institucionet shtetërore duhet të sigurojnë maksimumin për të rinjtë më e pakta duke qënë se punonjësit e kujdesit renditen si pika më e fortë nga të rinjtë duhet që ky kujdes të shtrihet minimumi deri në moshën që ligji i përcakton si fëmijë këta të rinj pra 18 vjeç.





#### 5.4 Raporti me familjen biologjike

Nga të rinjtë e intervistuar 26% e tyre shprehen se raporti me familjen biologjike është i dobët ose aspak. 26% e të rinjve marrëdhëniet me familjen i konsiderojnë kryesisht normale dhe pa probleme, por jo me ndonjë pritshmëri të madhe ndërsa 39% i shohin shumë të mira këto marrëdhënie, ndërsa për pak prej tyre familja siguron mbështetje financiare (13% e të rinjve) ndërsa emocionale akoma dhe më pak 8% e të rinjve.

#### 5.5 Raporti me kujdestarët e mëparshëm

- Nuk kam kontakt (4 të rinj); - I dobët (4 të rinj); - I përshtatshëm pa problem (5 të rinj); - Shumë i mirë (8 rinj)

Fëmijët e anketuar i shohin si mjaft të mira raportet me kujdestarët e mëparshëm rreth 62% të tyre ndërkohë që 38 % e tyre kanë pak ose aspak kontakt me kundestarët e mëparshëm. Ky fakt shërben dhe për të kuptuar atashimin e të rinjve me kujdestarët dhe se sa i rëndësishëm është figura e stafit në kujdes për të rinjtë.

##### Sugjerime:

Stafi në kujdes të jetë i qëndrueshëm dhe të mos ketë ndryshime të shpeshta sepse do jetë e vështirë për fëmijët e të rinjtë të familjarizohen, socializohen e krijojnë një marrëdhënie të qëndrueshme me to.

Të sigurohet vazhdimi i marrëdhënies së fëmijëve me kujdestarët dhe pas shkëputjes së kujdesit.

#### 5.6 Diskriminimi nga të tjerët

Një pjesë e konsiderueshme e të rinjve 38% e tyre, ndjehen të diskriminuar për faktin që jetojnë në institucione dhe preferojnë madje të mos tregojnë që jetojnë në institucione ndërkohë që shprehen se ky fakt i mërzit, trishton dhe shpesh herë ndjehen të fyer. Pjesa tjetër përballet me një diskriminim pozitiv 26% (6 të rinj). Fakti i një diskriminim pozitiv tregon që shoqëria jonë ndjehet e prekur nga fenomene të tilla dhe është burim mbështetjeje për grupime të ndryshme sociale sidomos për fëmijët që jetojnë në institucione. Gjithashtu 30% e të rinjve (7 të rinj) shprehen se nuk e kanë problem dhe nuk kanë diskriminim.

##### Sugjerime:

Punonjesi Social dhe psikologu në kujdes duhet të informojnë dhe të përgatisin të rinjtë se si të përballen me diskriminimin dhe mekanizmat për ta sfiduar dhe tejkaluar këtë fenomen. Gjithashtu ata duhet të këshillojnë dhe mbështesin të rinjtë pasi shpesh herë ndodh vetëizolimi, fajësimi, mospranimi dhe paragjykimi nga të rinjtë i vetvetes.

Një sensibilizim më i madh i shoqërisë për vlerat e të rinjve do ndikonte në një vlerësim më realistik dhe mbështetje më e mirë profesionale e emocionale nga personat jashtë kujdesit. Kjo mund të arrihet në bashkëpunim me psikologët në shkollë në informimin e bashkëmoshatarëve, kryesisht në ato shkollë ku ka një numër të konsiderueshëm të të rinjve nga kujdesi.

Diskriminimi pozitiv të kanalizohet, me mbështetjen e stafit në kujdes, në dobi të të rinjve për arrijtjen e qëllimeve jetësore dhe jo thjesht si shprehje keqardhje ose mëshire.

#### 5.7 Sukseset në jetë

Nga të dhënat e intervistave del se pjesa më e madhe e të rinjve, kanë renditur në vend të parë tek sukseset e tyre në jetë Shkollimin dhe rezultatet e mira mësimore 34%. Ky fakt mjaft domethënës pasi tregon që të rinjtë e shohin si prioritet dhe për ta ka rëndësi të madhe shkollimi (8 të rinj). Ata ndjehen mirë që ia kanë dalë të kenë një shkollim të kënaqshëm. Më pas tek sukseset të rinjtë konsiderojnë kurset dhe zanatet e përvetësuara (5 të rinj) si dhe angazhimi në aktivitete sportive (3 të rinj). 2 të rinj kanë renditur tek sukseset Aktivitetet Artistike, muzika dhe kërcimi. Të pakët janë ata të rinj që konsiderojnë sukses vetëmenaxhimin e buxhetit (vetëm një prej tyre) apo aftësitë sociale ndërkohë që një nga të rinjtë akoma nuk ka përcaktuar një sukses të tijin.

##### Sugjerime:



Dëshira e këtyre fëmijëve për të dalë mirë ne rezultatet shkollore është për t'u vlerësuar dhe për t'u inkujuar por do ishte e vështirë që ato të vetëm pa kujdesin dhe mbështetjen e duhur të vazhdonin të kishin rezultate të kënaqshme. Pra është esenciale që të rinjtë të vazhdojnë të jenë nën kujdes minimumi deri në përfundimin e shkollës së mesme.

## VI - DËSHIRAT PËR TË ARDHMEN

### 6.1 Shkollimi

Nga pothuajse të gjitha përgjigjet e të rinjve shprehet dëshira dhe nevoja e të rinjve për të mbaruar shkollimin e tyre konkretisht 83% (19 të rinj). Ambicja e tyre pozitive nuk kufizohet vetëm në përfundimin e shkollës së mesme por edhe në dëshirën për të vazhduar studimet e larta madje edhe për të studiuar jashtë vendit (3 të rinj). Vetëm një nga të rinjtë mjaftohej në përfundimin e kursit profesional apo nuk shprehte fare interes në arsimimin e tij. Kjo tregon ndërgjegjësimin e të rinjve për shkollimin dhe lidhjen e arsyeshme që ka një e ardhme e mirë me edukimin. Në kushtet e daljes jashtë kujdesit do ishte shumë e vështirë që dëshira e këtyre fëmijëve të konkretizohet ndaj është thelbësore (e rritshme) vazhdimi i kujdesit të të rinjve deri në momenti që dhe shkollimi i tyre do të ketë marrë një drejtim, për shumë prej tyre moshë 18 vjeç do përkojë më përfundimin e shkollës së mesme dhe vazhdimin e studimeve të larta.

#### Sugjerime:

Stafi në kujdes të ofrojë mbështetje dhe orientim të saktë në bazë të kompetencave arsimore të shfaqura nga të rinjtë për të planifikuar dhe nxitur perspektivat e edukimit që të rinjtë të zhvillojnë në të ardhmen.

Bashkëpunim i ngushtë me institucionet arsimore publike dhe jo publike i stafit dhe informim i të rinjve mbi arsimin cilësor. Negocimi, aplikimi dhe sigurimi i bursave nga punonjësit e kujdesit për nxënësit me rezultate të mira brenda dhe jashtë vendit.

### 6.2 Punësimi

Në lidhje me punësimin të rinjtë e dinë që është e nevojshme të punësohen për të përballuar jetesën pas daljes nga kujdesi (shumica prej tyre) por ka dhe nga ata që nuk kanë një ide në lidhje me punësimin. 2 prej të rinjve do të donin të punonin jashtë shtetit ndoshta kjo e lidhur me idenë e një jete më të mirë që mund të ofrohet nga vendet e huaja.

-E/I punësuar (12 të rinj); -Të punoja jashtë shtetit (2 të rinj); Jo përnjëherë (1 i ri); Jo i punësuar (1 i ri); Nuk e di (2 të rinj).

#### Sugjerime:

Rritja e informacionit dhe sensibilizimi i të rinjve mbi rëndësinë e punësimit nga stafi në kujdes. Përfshirja në planet e zhvillimit punësimi sezonal ose me orë të kufizuara për të rinjtë mbi 16 vjeç kryesisht në muajt e verës. Ky punësim do i ndihmojë në përmirësimin e aftësive social-emocionale, menaxhimin financiar, ndërveprimin me persona jashtë kujdesit do rrisë kompetencat e tyre dhe eksperiencën e fituar do ti ndihmojë ta kenë më të lehtë integrimin në tregun e punës në të ardhmen.

### 6.3 Marrëdhëniet Personale

Në planin e marrëdhënieve personale disa nga të rinjtë i konsiderojnë ato të mira (4 të rinj) apo shumë të mira (5 të rinj), 2 nga të rinjtë tek marrëdhëniet personale kanë vlerësuar shoqëritë e reja që kanë krijuar. Një nga të rinjtë shprehet për bashkimin me fisin, marrëdhënie të reja në këtë drejtim. Një nga të rinjtë shprehet Të fejohej, martohem e të jem e denjë të kem 1 familje. Ndërsa njëri nga të rinjtë shprehet Dëshiroj të jem jashtë shtetit.

#### Sugjerime:

Të Rinjtë të informohen dhe mbështeten nga stafi në kujdes për të krijuar marrëdhënie të shëndetshme personale dhe ruajtur e forcuar marrëdhëniet ekzistuese. Të zgjerohet rrjeti social i të



rinjve me persona të tjerë jashtë kujdesit pasi do jetë element kyç për kalimin në pamvarësi të plotë dhe do lehtësojë integrimin e tyre në të ardhmen.

#### **6.4 Shëndeti**

Të rinjtë e intervistuar gëzojnë shëndet të kënaqshëm, janë shprehur shumë mirë (9 të rinj) ndërsa Mirë (4 të rinj). Është mjaft e rëndësishme që ky shëndet të jetë i mirë dhe pas daljes nga kujdesi. Ky shëndet sigurohet nga kujdesi që të rinjtë marrin por situata nuk do jetë e njëjtë në momentin që ata do e lënë kujdesin dhe nuk do ketë persona mbështetës. Vetëm një nga të rinjtë është shprehur se Nuk e di mbi shëndetin.

#### **Sugjerime:**

Të rinjtë të marrin informacion të vazhdueshëm mbi mënyrat e kujdesit për shëndetin, profesionistët e shëndetit dhe institucionet publike dhe jo publike të shëndetit.

#### **6.5 Mbështetja që kërkohet**

- Mbështetje Financiare (6 të rinj);
- Mbështetje për sportin (6 të rinj);
- Shkollimin e lartë (3 të rinj);
- Mbështetje për kurse & talente (3 të rinj);
- Strehimin (2 të rinj);
- Punësimin (1 i ri);
- Mbështetje nga Stafi (1 i ri).

Për periudhën pas daljes nga kujdesi të rinjtë ngrenë një larmi shqetësimesh/çështjesh të ndryshme për mbështetje. Kjo varion nga mbështetje financiare apo mbështetje për të vazhduar të ushtrojnë aktivitetet sportive, mbështetje u nevojitet për të vazhduar studimet e larta sikurse u duhet mbështetje për strehim, punësim apo mbështetje për të zhvilluar talentet e tyre. Të shumta janë nevojat që të rinjtë kanë shprehur për vazhdimin e jetës së tyre normalisht, pa dyshim për të pasur të njëjtat mundësi si bashkëmoshatarët që janë në kujdesin e familjeve. Bashkë me përgjigjet e dhëna të rinjtë bëjnë apel për vëmëndje nga institucionet dhe shoqëria.

#### **Sugjerime:**

Që mbështetjet e nevojshme të cilësuara më lart nga të rinjtë të jenë të plota, të qëndrueshme dhe vizionare rekomandimi kryesor mbetet rritja e moshës në kujdes publik minimumi deri në 18 - vjeç.

Këto nevoja mund të mbulohen me përmirësimin e kuadrit ligjor dhe zhvillimin e politikave të qarta, shoqërimin me buxhete reale për zbatimin konkret të politikave nga institucionet publike të kujdesit, të cilat nga ana e tyre duhet të garantojnë një kujdes cilësor për fëmijët dhe të rinjtë. Këto çështje mund të konsiderohen dhe garantohen shumë mirë në kontekstin e reformës së sistemit të shërbimeve sociale për fëmijë, de-institucionalizimit dhe transformimit të shërbimeve rezidenciale të kujdesit në tipologji të reja shërbimesh, të parashikuar dhe në planin e veprimit për fëmijët 2012 – 2015.

Një element kyç për një kujdes cilësor mbeten trainimi dhe kompetencat e stafit që ofrojnë shërbime në kujdes, zbatimin e standarteve për fëmijët në institucionet rezidenciale nga stafi dhe inspektimi i vazhdueshëm e profesional nga institucionet monitoruese.



## VII. Pjesa e shtatë - Sugjerime / rekomandime

---

### Masat institucionale për mbrojtjen e fëmijëve jetimë dhe pa kujdes prindëror

---

Masat që duhen ndërmarrë nga shteti për mbrojtjen e fëmijëve jetimë dhe pa kujdes prindëror:

1. Parandalimi i institucionalizimit të fëmijëve
  - Trajtimi i përkohshëm i tyre në Institucionet e Përkujdesit Shoqëror dhe vetëm në rastet e emergjencës
  - Hartimi i planeve të qarta të përkujdesit për fëmijët e institucionalizuar
  - Zbatimi i detyrimeve të Ligjit Mbi Statusin e jetimit nga të gjitha ministritë e linjës.
  - Marrja e rolit të përgjegjësitet dhe liderit të MPÇSSHB në zbatimin e detyrimeve të Statusit të Jetimit dhe miratimi i sanksioneve (të paktën administrative) për ata që nuk zbatojnë legjislacionin në fuqi.
  - Harmonizimi i politikave të pushtetit qendror me pushtetin vendor për zgjidhjen e problemeve sociale të jetimeve të cilët kane përparësi në strehim, punësim etj.
  - Vënia në funksionim të plotë e shërbimit të kujdestarisë së përkohshme, në programet e të cilëve të kenë përparësi fëmijët jetimë që trajtohen në familjet e të afërmeve.
  - Shtimi i mbështetjes shtetërore për veprime të shoqërisë civile që adresojnë çështjet e jetimëve
  - Ndërmarrja e masave më të mëdha për ndërgjegjësimin e shoqërisë për adresimin e problemeve të jetimëve.
2. Ndjekja e Udhëzimeve të Kombeve të Bashkuara mbi kujdesin alternativ të përkohshëm për kategorinë e jetimëve.
3. Ofrimi i alternativave të përkujdesit shoqëror për trajtimin aktual të fëmijëve jetimë.
4. Përpunimi i statistikave të sakta në nivel kombëtar i jetimëve të Shqipërisë, përfshirë edhe ata që jetojnë pranë të afërmeve.



## Sugjerime / rekomandime

---

- Në lidhje me parashikimin ligjor (N.1,1 i ligjit për Statusin e Jetimit) se fëmijët jashtë martesë përfitojnë statusin e jetimit automatikisht. Kushtetuta i barazon fëmijët jashtë martesë me ato brenda martesë dhe ky parashikim mund të shihet si një trajtim i diferencuar i fëmijëve. Gjithashtu, rezulton se ka një sërë rastesh të përfitimit abuziv nga ky parashikim ligjor. Sugjerojmë që ky parashikim të rishikohet.
- Duhet të shihet mundësia e përfitimit të ndihmës sociale edhe nga jetimët që nuk i kanë prindërit por jetojnë me të afërm dhe janë nën moshën 18 vjeç.
- MPCSSHB duhet të marrë rolin e liderit në përmbushjen e kërkesave nga të gjithë ministritë e linjës në mënyrë që të zbatojnë me përpikëri ligjin e statusit të jetimeve.
- Duhet të krijohen apartamente sociale, qoftë edhe në nivel të qeverisjes qendrore për të menaxhuar rastet emergjente të cilat nuk mbulojnë nga politikat e strehimit.
- Duhet të zbatohen me rigorozitet nga strukturat shtetërore rregullimet ligjore mbi përfitimet në aspektin shëndetësor, arsimor.
- Të gjitha strukturat përkatëse qeveritare në politikat e tyre duhet të integrojnë dhe favorizojnë kategoritë e jetimëve.
- Politikat shtetërore duhet t'i kushtojnë vëmendje maksimale fëmijëve që dalin nga përkujdesi shtetëror duke vijuar përkrahjen ndaj tyre. Është e domosdoshme që të hartohen plane të qarta për ta nga grupet multidisiplinare specialistësh.
- Krijimi i programeve dhe paketave konkrete për mbështetjen e të rinjve të cilët përkatën për të dal nga kujdesi alternativ, veçanërisht fëmijët që largohen në moshën 16 vjeç. Ose krijimi i mundësive për ofrimin e shërbimit të familjes kujdestare për këtë kategori.
- Krijimi i hapësirave për pilotimin e programit rinor (16-18 vjeç) si një mundësi e mirë brenda reformës aktuale brenda institucionit Zyber Hallulli dhe zgjerimit të tij të mëtejshëm edhe në institucione të tjera.
- Marrja e masave për integrimin në familjen biologjike për fëmijët për të cilët është e mundur.
- Ngritja e grupeve të punës dhe mbështetëse (punonjës socialë, etj për të mbështetur të rinjtë gjatë kohës së tranzicionit të largimit nga kujdesi deri në gjetjen e një pune dhe të një strehimi). Si modele në këtë drejtim mund të përdoren edhe praktikatat e mira të zhvilluara nga organizatat me eksperiencë në këtë drejtim.



## Literatura

- 1- Ageing out of care: From care to adulthood in European and Central Asian societies  
Lerch, V. with Stein, M. (eds.) (2010) SOS Children's Villages International, Innsbruck, Austria.  
[http://socialtransitions.kdid.org/sites/socialtransitions/files/resource/files/Childrens%20Villages%20Ageing%20out%20of%20care\\_2010.pdf](http://socialtransitions.kdid.org/sites/socialtransitions/files/resource/files/Childrens%20Villages%20Ageing%20out%20of%20care_2010.pdf)
- 2- Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Përkujdesjen Alternative për fëmijët – SOS Fshatrat e Fëmijëve Ndërkombëtar dhe Shërbimi social Ndërkombëtar.  
<http://www.coe.int/t/dg3/children/ChildrenInCare/SOS-ISS%20Guidelines%20Publication.pdf>
- 3- Botimi: Në vijimësi të konferencës së Reformës së Shërbimeve sociale në Shqipëri, Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara mbi Përkujdesjen Alternative për Fëmijët- Dokumentimi i ecurisë së konferencës – Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, UNICEF dhe SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri. Tiranë 21-22 Qershor, 2011.
- 4- Raporti Universal Periodik: BKTf dhe SOS Fshatrat e Fëmijëve  
[http://lib.ohchr.org/HRBodies/UPR/Documents/Session6/AL/ATACT\\_ALB\\_UPR\\_S06\\_2009.pdf](http://lib.ohchr.org/HRBodies/UPR/Documents/Session6/AL/ATACT_ALB_UPR_S06_2009.pdf)
- 5- Ligjet dhe strategjite e perdorura ne studim mund ti gjeni në  
<http://www.qpz.gov.al>
- 6- Të dhënat e raportit “Kërkim midis Bashkëmoshatarëve” 2012, SOS Fshatrat e fëmijëve dhe bashkëfinancuar nga Komisioni Europian.  
<http://www.sos-childrensvillages.org/What-we-do/Child-Care/Quality-in-Care/leaving-care-good-practice/Documents/Peer-Research-Albania-EN.pdf>